
| | |
|---|----|
| Parapagimi për revistën..... | 2 |
| Dështimi i luftës kundër terrorizmit..... | 3 |
| Mirësevjen muaj i Ramazanit..... | 7 |
| Kështu duhet zgjedhur shokët..... | 10 |
| Teubeja në Ramazan..... | 12 |
| Konfrontimi mes njeriut dhe shejtanit..... | 17 |
| Ekstremizmi..... | 27 |
| Zmadhimi i mëkatit në Ramazan..... | 31 |
| Këshillë bashkëshortëve..... | 35 |
| Gruaja e duhanxhiut..... | 37 |
| Nëna dhe gruaja e babait..... | 39 |
| Muhammed Isma'il Es Selefî..... | 42 |
| Muaji Ramazan..... | 43 |
| Besimi në pejgamberët e Allahut..... | 47 |
| Një ulje me dijetarin e madh Nasirudin Albanin..... | 49 |
| Ndalimi i të menduarit keq për tjerët..... | 55 |

Parapagimi për revistën

Parapagimi kushton gjithsej **10** euro për Europë, (përfshirë edhe Shqipërinë, Kosovën, Turqinë dhe ish republikat Jugosllave), **20** euro për Kanada dhe Amerikë dhe vetëm **310** denarë për parapaguesit nga Maqedonia. Me këtë parapagim brenda një viti juve ju dërgojmë 12 numra të revistës, prej numrit aktual kur ju parapaguheni. Në këtë çmim janë të përfshiera edhe harxhimet postare për dërgim të thjeshtë.

Për parapagim mjafton që të dërgoni pajtimin tuaj me emrin dhe adresën e plotë në:

email: albislam@albislam.com

sms: +389 75 436 718

fax: +389 2 3230 827

tel: +389 2 3230 827 (çdo ditë, përveç të xhumasë dhe të dielës, prej 9 deri 16)

ose me postë në: rr: 110 nr: 5 1000 Shkup, Maqedoni

viti IV nr: 38

redaksia: Omer Berisha (kryeredaktor),
Bekir Halimi, Talha Kurtishi, Fatmir Zaimi,
Ali Shabani, Agim Bekiri, Metush Memedi

albislam@albislam.com

rr: 110 nr: 5

Çarshija e vjetër

1000 Shkup

fax: +389 2 3230827

Del në fillim të muajit, kalendari i hixhretit, takvimi i Türkiye Diyanet Vakfi. Numri i ardhshëm: 24 09 2006

Boton: NUN-R DOOEL

Xhirollogaria: 300000001759616 Komercijalna Banka A.D. - Skopje (denar)

Xhirollogaria: 0270100209184 Komercijalna Banka A.D. - Skopje (euro)

rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4

S.W.I.F.T. : KOBSMK2X

IBAN MK07300701002091869

Numri tatimor: 4030003487017

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2.

Shtypur në: Cetus Print -Shkup Tirazhi: 1000 kopje ISSN: 1409-6250

Dështimi i luftës kundër terrorizmit

“Nese ia tregon nje populli nje genjeshter te madhe dhe duke e perseritur ate vazhdimisht poopulli do ta besoje si te vertete. Kjo genjeshter do te zgjatë deri sa Shteti do ta mbroje popullin nga pasojat e genjeshtres qofshin ato politike, ekonomike dhe ushtarake.

Pastaj behet shume e rendesishme per Shtetin qe t'i shfrytzoje te gjitha forcat per ta fshehur kete genjeshter pasiqe e verteta eshte armiku vdekjeprures ndaj genjeshtres kurse kjo ne pergjithesi dmth: E verteta eshte armiku i Shtetit.”

Joseph Goebbels

Sulmet e 11 shtatorit ndaj SHBA-ve ishin ngjarjet më të mëdha në politikën moderne prej dështimit të Bashkimit Sovjetik kurse tash është bërë 5 vjetori i këtyre ngjarjeve historike.

11 Shtatori “ndryshoi çdo send”, ishin fjalët që i tha George W. Bush. Pas sulmeve u deklarua “Lufta Kunder Terrorizmit” duke u bazuar ne grupet terroriste dhe shtetet që përkrahnin organizatat terroriste (Shtetet që nuk ishin proamerikane) te ashtuquajtura nga SHBA-te (anti-SHBA grupe).

Së pari, sulmuesi i dyshuar ishte organizata Al-Kaida me udhëheqesin e tyre Osama bin Laden. Sot, Bin Ladeni akoma nuk është kapur përsëri insistimit të SHBA-ve që të kapej “I gjalle ose I vdekur”. Intelejencia perëndimore thekson se kjo organizatë ka marrë dëme të mëdha por tërheq vëmendjen se kjo organizatë akoma mund të funksionojë

dhe te veproje si frymezim per organizatat tjera qe kane te njejat qellime si ato te Al-Kaides. Disa nga qellimet jane: Kundershtimi ndaj shtetit te Izraelit, largimi i prezencës Amerikane në Lindjen e Afërme si dhe pengimi i përhapjes së demokracisë nëpër botën Islame me perkrahen e Amerikës ndaj regjimeve “miqësore”.

Një bazë e ashtuquajtur Guantanamo në Kubë u hap për t'i marrë në pyetje, torturë bile edhe t'i vrasë të dyshuarit për sulme në vend se të kapen të dyshuarit për sulmet.

Tashmë edhe George W. Bushi ka pranuar se ekzistojnë kampe tjera nëpër vende tjera ku të dyshuarit mbahen dhe torturohen.

Nuk ka nevojë që te imagjinohet shumë rreth torturave që i nënshtrohen të dyshuarit duke pasur parasysht imazhet e feliqura nga burgu i Abu Graib, që u publikuan më herët.

Fakti që këto arrestime dhe tortura janë të ndaluara me ligjet ndërkombëtare bile as që po i pengon punës së përditshme të Administratës së Bushit. Konventa e Gjeneves për trajtimin e te burgosurve ishte e definuar si “antike” nga Prokurori publik i administratës së Bushit. Asnjë nga të dyshuarit e mbajtur në SHBA nuk do te akuzohet për krime të bëra. Keto kampe torturash kane përshkruar aq bukur (saqe as Al-Kaida nuk mund ta bente më mire) që SHBA-të nuk respektojnë të drejtat njerëzore dhe ligjet

nderkombetare, nderkohë që për ushtarët e saj te jene te mbrojtur po nga te njejtat te drejta dhe ligje.

Së dyti, Bombardimi dhe invazioni i Afganistanit u pa si një fitore e hershme dhe e rëndësishme për luftën e Bushit kunder terrorizmit.

Regjimit Taliban i ishte servuar një ultimatum që të bënte dorezimin e Osama bin Ladenit me 20 shtator 2001. Regjimi Taliban me plot të drejtë kërkoi prova (dëshmi) për involvimin e të kërkuarve në sulmet e 11 shtatorit.

Kjo kërkese është parë nga SHBA-të si shokuese, kështuqë pa ndonjë deklaratë lufte filloi te ndodhë një bombardim masiv ajror mbi Afganistanin më 7 tetor 2001. Sipas parimeve legale kjo ishte "ilegale". Nese kjo ka logjike të shendoshe atëhere ne do ta arsyetonim nje sulm te papritur të Anglise mbi Amerikën ngase disa nga anetaret e IRA-s jetonin dhe vepronin në Amerike (1980) ose do ta kishim arsyetuar nje sulm te Spanjës mbi Francen ngase disa separatistë Bask të grupit ETA jetonin atje.

Bota shikoi heshtazi bombardimin e një shteti shumë të varfur dhe të shkatërruar nga lufta me bomba dhe mjete tjera shkaterruese. Afganët, të cilët asnjëhere nuk kishin dëgjuar për Al-Kaiden, ndërsa vriteshin dhe mbyteshin për diçka që nuk ishte pergjegjësi e tyre dhe po përballonin armet më moderne dhe të sofistikuar që njerezimi kishte parë.

Ngjarjet e fundit ne Afganistan demonstuan se sa sipërfaqesor është sukcesi i SHBA-ve dhe se kishin nencmuar kapacitetin e atij populli për luftime të gjata guerile.

Udhëheqesat e NATO-s pranuan se nuk kontrollonin 4/5-tat dhe se Talibanët ishin

duke u përforcuar dhe sofistikuar vazhdimisht. Kryetari i zgjedhur nga SHBA-të, Hamid Karzai, është gjithashtu i njohur si "Prefekti i Kabullit" nga shkak i paaftësisë së tij të kontrollojë pjesët tjera të shtetit kurse ngjarjet e fundit demonstuan se edhe Kabulli nganjëherë është shumë i madh për ta kontrolluar.

Karzai është i mbrojtur nga mercenaret Amerikan nga shkak se ai beson që afganët nuk janë të aftë për këtë detyrë dhe se edhe familja e tij qëndron jashtë shtetit për shkaqe sigurie.

Veprimi i trete i Luftes kunder terrorizmit ishte invazioni dhe okupimi i Irakut në fillim të 2003-tës. Gjatë 2002 u bë e qartë se Administrata e Bushit bënte çmos që të gjente pretext për fillimin e invazionit të Irakut. Problemi ishte gjetja e diçkaje që do të përkrahte një invazion të tillë nga publiku amerikan dhe koalicioni i mundshem nga shtetet tjera. Qeveria amerikane filloi duke thënë se ekziston një lidhje mes Sadam Huseinit dhe 11 shtatorit, dhe se Iraku po prodhonte armë për shkatërrim masiv (kimike dhe biologjike) dhe se duhej patjetër të ndalet para se t'ia jepte keto armë për shkatërrim masiv Al-Kaides. Problemi me këtë deklaratë ishte jo vetem që nuk ishte e vertete por edhe vetë Qeveria Amerikane e dinte fare mirë që nuk ishte e vertete. Nuk kishte asnje lidhje mes Sadam Huseinit dhe Bin Ladenit dhe kjo u vertetua me raportin e Senatit Amerikan të leshuar më 8 shtator 2006 që detyroi të heshtin ata që thonin se ky ishte rasti për futjen në Irak. Në lidhje me Armet për shkatërrim masiv, Sadam Huseini lejoi inspektorët nga Kombet e Bashkuar për hetime të plota dhe të papenguara mu ashtu siç kërkohet nga Rezoluta 1441 e

KB. Në dhjetor 2002, Iraku i dha Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara një dokument me 12.000 faqe ashtu siç parashikonte rezoluta 1441. SHBA-ja mori të vetmen kopje kurse Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara iu dha një kopje e ndryshuar. Ambasadori Amerikan në KB, Negroponte, pohoi se SHBA-ja i kishte dhënë anëtarëve të KB një kopje me disa shtesa teknike. Delegacioni Sirian kundërshtoi pranimin e këtij dokumenti të ndryshuar nga SHBA dhe kërkoi dokumentin original, i cili asnjëherë nuk u dorëzua.

Të trishtuar nga fakti se inspektorët e KB duhej të raportonin në mesin e 2003 se Iraku nuk posedon Armë për Shkatërrim masiv, qeveria Amerikane deklaroi se Sadami po mundohet të blejë kohë dhe kështu që duhej një aksion urgjent dmth: duhej invazion dhe okupim i Irakut para se të bëhej shumë vonë. Parashihej se Ushtria Irakiane nuk mund t'i kundërvohej një ushtrie tepër e armatosur e cila ishte e përgatitur financiarisht në mënyrë superiore mirepo Kryengritja Irakiane dëshmoi se çdo superfuqi ka "limited" dhe ka përgënjeshtuar mitin Amerikan për një ushtri Amerikane të padukshme.

Menjëherë pas pushtimit të Irakut u formua Grupi për Studim të Irakut nga Bushi për raportim të gjetjes së Armeve për Shkatërrim masiv, e cila ishte e udhëhequr nga një mik i vjeter i Bushit. Ky Grup me 30 shtator 2004 konkludoi se nuk kishte arme biologjike dhe kimike në Irak para okupimit dhe as që u gjet prova për planifikim të krijimit të tyre. Pasi që mungon një Rezolutë nga KB për ndalim të çdo sulmi ushtarak ndaj ndonjë shteti pa patur ndonjë dëshmi, e në këtë rast si

të qeverisë Amerikane për dëshmi të rreme, e gjithë bota mendon se qeveria e Bushit ka vepruar në menyrë ilegale.

Si rezultat i kësaj është plagosja dhe vrasja e mijerave Irakenëve të pafajshëm, shkatërrimi i infrastruktures, shkatërrimi i ligjit dhe rendit publik gjatë okupimit dhe emigrimi i mijëra irakenëve intelektualë, të cilët nuk mundën ose nuk duan që të kthehen dhe të jetojnë nën okupimin brutal të Amerikës. Si do të kompensohet Iraku nga ky veprim i paligjshëm i Amerikës është vështirë të kalkulohet si në term qenjësor ashtu edhe financiar. Nëse hyrja në luftë me dëshmi të rreme – e sidomos në këtë rast – atëhere çdo qeveri e ardhshme legjitime e Irakut duhet të kërkon nga Kombet e Bashkuara se lufta e Irakut ka qenë Krim Luftë dhe se Iraku duhet të kompensohet totalisht. Lajmi më i mirë për botën është se shumica e popullit Amerikan ka kuptuar se Bushi dhe qeveria e tij kanë genjyer dhe mbi 60% e popullit amerikan besojne se okupimi i Irakut ka qenë gabim dhe se populli Amerikan ka qenë i keq udhëhequr nga qeveria e tyre.

Tashme bëhen 5 vjet, dhe Lufta Kunder Terrorizmit ka qenë shumë e suksesshme në krijimin e armiqve të rinj dhe të llojllojshëm. Gjithashtu ka bërë që shtetet si Izraeli dhe Rusia të shtypin brutalisht myslimanet dhe të arsyetohen se kinse ata tashme e kanë "Luftën e tyre kundër Terrorizmit."

Do të duhej një person shumë i guximshëm dhe budalla për të deklaruar se "Lufta Kunder Terrorizmit" kishte fituar në njëfarë mënyre. Asgjë s'do të mund ta dëshmonte pakësimin e perkrashjes ndaj kësaj lufte përveç se para 5 viteve një gazetë franceze vendosi në titull "Ne jemi

me Amerikanët” kurse para 3 javëve në protestat e Londres shiheshin banerat “Ne jemi me Hezbollahun”.

Lufta Kunder Terrorizmit nuk ka përfunduar dhe nuk do te mbarojë

përderisa në SHBA kemi udheheqës neo-konzervativ por me rëndësi është se paaftësitë dhe gënjeshttrat e tyre tashmë i dijmë të gjithë.

Dr. Steven Harris
Përktheu: Omar bin Fehmi
Redaktoi: O. B.

Mirësevjen muaj i Ramazanit

Muaji i Ramazanit ka arritur përsëri, muaji i agjërimit dhe i lutjeve (namazit). Është muaji që jep një mundësi për falje nga Allahu dhe shpëtim nga mëkatet tona. Është muaji ku bëjmë vepra të mira dhe japim lëmoshë. Është muaji kur hapen dyert e Xhenetit dhe shpërblimet për punët tona janë të lartësuar shumëfish. Është muaji ku lutjet pranohen, dhe statusi i besimtarit është i lartësuar. Është muaji ku mëkatet falen. Allahu dhuron më shumë mëshirë (bekime) për robërit e Tij në muajin e Ramazanit. Ky është muaji i agjërimit që është një nga pesë shtyllat e islamit. I dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, agjëroi gjatë këtij muaji dhe i udhëzoi ndjekësit e tij që ta bëjnë të njëjtën. Ai na tregoi se kushdo që e agjëron këtë muaj me besim, duke kërkuar shpërblimin e Allahut, subhanehu ve teala, do t'i ketë të gjitha mëkatet e kaluara të tij të falura. Ai, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, gjithashtu na tregoi se kushdo që qëndron (bën) në namaz gjatë gjithë këtij muaji do t'i falen të gjitha mëkatet e tij.

Në muajin e Ramazanit është një natë e cila është më e mirë se një mijë muaj. Kushdo që e mohon mirësinë (begatinë) e kësaj nate vërtetë është i humbur.

Duhet ta mirëpresim këtë muaj dhe ta shfrytëzojmë në lumturi dhe në gëzim. Duhet të kryejmë agjërimin dhe namazin dhe të garojmë në vepra të mira. Gjatë këtij muaji duhet me vullnet të plotë të pendohemi për të gjitha mëkatet tona dhe ta nxisim njëri-tjetrin që të punojë punë të mira

dhe të thërrasim në çka është e mirë dhe të ndalojmë të keqen. Në këtë mënyrë do të arrijmë ta fitojmë mëshirën dhe shpërblimet e mëdha të Ramazanit.

Agjërimi na dhuron shumë dobi dhe është përplot urtësi. Pastron dhe forcon zemrat tona. Na shpëton (çliron) nga priret tona të ulëta si : pasuria e tepërt, mendjemadhësia, dhe koprracia. Përforcon cilësitë tona të mira si : qëndresa, mëshira, dhe bujaria. Na ndihmon në luftën tonë të brendshme që të kënaqim Allahun dhe të arrijmë afërsinë tek Ai.

Agjërimi na mëson për nevojat tona. Na tregon se sa te dobët jemi dhe sa jemi të varur nga Zoti jonë. Na tregon se sa shumë Allahu na ka begatuar. Detyrohemi ta falënderojmë Allahun dhe t'i shfrytëzojmë begatitë që Ai na ka dhënë në bindje (dëgjueshmëri) ndaj Tij.

Allahu na tërheq vëmendjen te këto dobi të shumta kur thotë: "O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm." -sure El-Bekare, 183.

Në këtë ajet Kur'anor, Allahu na bën të qartë se na është urdhëruar agjërimi në mënyrë që të na pastrojë.

Agjërimi është një mjet (mënyrë) për ne që ta mësojmë vetëpërbajtjen dhe të kultivojmë devotshmërinë tonë. Devotshmëria është të zbatohen urdhrat dhe të braktisen ndalesat e Allahut dhe të dërguarit të Tij, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, me zemër të pastër larg

dëshirave tona, dhe në përkulje ndaj Allahut, dhe t'iu shmangemi dënimit dhe hidhërimit të Tij.

Agjërimi është një vepër e madhe në vetvete dhe një mënyrë kryesore në ngritjen e devotshmërisë tonë në të gjitha aspektet e jetës tonë materiale dhe fetare.

I dërguari i Zotit, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, na tregoi njëherë nga dobitë e agjërit kur thotë: “O të rinj, kush prej jush ka mundësi që të martohet, le ta bëjë, sepse kjo është më së miri për ruajtjen e shikimit dhe organeve intime. E kush nuk ka mundësi, atëherë le të agjërojë, sepse agjërimi e zvogëlon epshin (aftësinë seksuale)”.

Arsyeja që agjërimi ka këtë efekt është sepse djalli lëviz (qarkullon) si gjaku nëpër damarët tanë. Agjërimi përmban këtë lëvizje, ndërkohë që vepron si një përkujtim i Allahut dhe madhështisë së Tij, në këtë mënyrë redukton ndikimin e djallit mbi personin që agjëron gjersa në të njëjtën kohë besimi i Tij forcohet (rritet). Ai natyrisht fillon të merret me më shumë vepra të mira dhe me më pak mëkate.

Ka shumë dobi tjera të agjërit që ne i zbulojmë me një të menduar dhe reflektim të vogël.

Agjërimi është i mirë edhe për shëndetin trupor. Ai i jep trupit një mundësi që ta pastrojë veten nga helmet e mbledhura, një fakt i cili është i vërtetuar nga mjekë të shumtë. Ajetet Kur'anore na flasin gjerësisht për mirësitë (vlerat) e agjërit në muajin e Ramazanit dhe të qenët një detyrim për besimtarët. Allahu thotë: “ O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm. (jeni të obliguar për) Ditë të caktuara...” , “ (ato ditë të numëruara janë) muaji i Ramazanit

që në të (filloi të) shpallet Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria). E kush e përjeton prej jush këtë muaj, le ta agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju. (të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) Që të plotësoni numrin, të madhëroni Allahun për atë se ju udhëzoi dhe që të falënderoni”. Sure El-Bekare, 183-185.

I dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, ka thënë: “Islami është ngritur mbi pesë shtylla: Dëshmisë se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Allahut, falja e namazit, dhënia e zeqatit, agjërimi i muajit të Ramazanit dhe kryerjes së haxhit për atë që ka mundësi. (Sahihul Buhari dhe Muslim)

Kur melaqja Xhibril e pyeti të dërguarin e Zotit, për islamin, ai u përgjigj: “Islami është të dëshmosh se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguar i Tij, ta falësh namazin, ta japësh zeqatin, ta agjërosh Ramazanin dhe ta vizitosh shtëpinë e shenjtë - Qabën, nëse ke mundësi ta bësh këtë. (Suneni i Tirmidhiut)

Xhibrili a.s. pastaj i tha : “Të vërtetën e the”, pastaj ai i tha : “Më trego për besimin?” I dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, u përgjigj: “Të besosh në Allahun, në melaqet e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij, ditën e Fundit dhe të besosh në caktimin e Tij të së mirës dhe të së keqes.” Ai i tha : “Të vërtetën e the” tha: “Më trego ç'është ihsani (bamirësia)?” I dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, tha: “Ta adhurosh Allahun sikur ta shohësh, edhe pse ti nuk e sheh, Ai

ty të sheh” Ai tha: “Të vërtetën e tha”. (Sahihul Muslimi)

Ky hadith është me rëndësi mjaft të madhe dhe meriton një vëmendje serioze.

Njëherë Muadh ibn Xhebeli i tha të dërguarit të Zotit, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të: “Më trego disa vepra që më mundësojnë të hyj në xhenet dhe që më largojnë nga xhehenemi” I dërguari i Zotit, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, iu përgjigj: “Ju keni pyetur për diçka të madhe, sidoqoftë është shumë e thjeshtë për njërin të cilit Allahu ia bën të lehtë. Adhuroje Allahun dhe mos i shoqëro askënd në adhurim, fale namazin, jepen zekatin, agjëroje ramazanin, dhe vizitoje shtëpinë e shenjtë - Qabenë, nëse ke mundësi ta bësh”, pastaj i dërguari i Zotit, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, shtoi : “A doni t’ju informoj për dyert e mirësisë? Agjërimi është xhenet. Lëmosha i asgjëson mëkatet sikur uji që e shuan zjarrin. (Suneni i Tirmidhiut)

Agjërimi është një vepër shumë e virtytshme me një shpërblim proporcional (të barabartë) me madhësinë e saj. Kjo është veçanërisht në Ramazan, qëkur Allahu e ka bërë agjërimin një obligim për besimtarët dhe një mjet për të arritur shpëtimin.

I dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, ka thënë: “Çdo vepër e njeriut është për veten e tij dhe shpërblimi i saj është i shumëfishuar për atë nga dhjetë deri shtatëqind herë. Allahu thotë: ‘Përveç agjërimit, vërtetë ai është për Mua, dhe vetëm Unë do të shpërblej për atë posaçërisht, vërtetë ai i len epsheet e tij, ushqimin e tij, dhe pijen e tij për hir Timin’. Ai i cili agjëron përjeton dy gëzime, njërin kur ai bën iftar, dhe tjetrin kur të takon Zotin e tij. Padyshim, era e gojës së agjëruesit

është më e këndshme tek Allahu se aroma e miskut. (Sahihul Buhari dhe Muslim)

I dërguari i Zotit, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, ka thënë: “Kur të vjen Ramazani hapen dyert e xhenetit, mbyllën dyert e xhehenemit dhe lidhen djajtë”. (Sahihul Buhari dhe Muslim)

I dërguari i Zotit, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, thotë: “Në natën e parë të Ramazanit, djajtë dhe xhinët e pabindur janë të lidhur me zinxhirë. Dyert e xhenetit janë të hapura gjersa asnjë derë e vetme nuk mbetet e mbyllur. Dyert e xhehenemit janë të mbyllura gjersa asnjë derë e vetme nuk është e hapur. Pastaj një thirrës thërret : ‘O kërkues të së mirës, ecni përpara! O kërkues të së keqes, burgosni veten! Allahu liron njerëzit nga xhehenemi çdo natë”. (Suneni i Tirmidhiut)

Në prag të Ramazanit, i dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, mbajti një fjalim dhe tha: “O njerëz, një muaj i shkëlqyer dhe i bekuar është duke ardhur tek ju, një muaj që përmban një natë më të mirë se njëmijë muaj”.

Allahu ka bërë agjërimin në ditët e caktuara një obligim dhe të falet namazi në netët e tij si një vepër vullnetare. Kushdo që kërkon afërsinë tek Allahu në këtë muaj përmes ndonjë veprë të moralshme do të ketë sikur njëri i cili kryen një obligim fetar në kohën tjetër dhe kushdo që bën një vepër të obliguar të adhurimit në këtë muaj do të ketë sikur ai që bën shtatëdhjetë vepra të tilla në kohën (herën) tjetër. Është muaji i durimit, dhe shpërblimi për durimin është xheneti”. (Sahih Ibën Huzejme)

Duhet ta shfrytëzojmë rastin e mundshëm tek ne në këtë muaj të bekuar dhe ta çmujmë madhësinë e kësaj kohe me adhurime të shumta që mund të bëjmë. Duhet të nxitojmë që të bëjmë punë të mira.

Allahu e ka bërë këtë muaj një kohë për adhurim dhe për garë me njëri-tjetrin në të mira. Duhet t'i shpresojmë lutjet tona dhe të shpenzojmë kohën në bamirësi. Duhet ta shpresojmë leximin e Kuranit famëlartë, të nxitojmë që t'i ndihmojmë të varfrit, nevojtarët, dhe jetimët.

I dërguari i Zotit, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, ishte më bujari nga të gjithë njerëzit në muajin e Ramazanit. Duhet të ndjekim shembullin e përsosur të të dërguarit të Zotit, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, duke shtuar përpjekjet tona në vepra të mira në këtë muaj. Duhet t'i ruajmë të mirat e agjërimit tonë nga mëkatet tona dhe nga të metat tona. I dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, " Kushdo që nuk e lë të gënjerit dhe të vepruarit sipas saj, Allahu nuk ka nevojë që ai ta lë të ngrënit e të pirët. (Sahihul Buhari)

I dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, " Agjërimi është mbrojtje, e ai që është duke agjëruar nuk guxon të flasë fjalë të turpshme e as ta ngrejë zërin, ndërsa nëse dikush e ofendon (shan), ose e kundërshton (fjaloset me te), le të thotë : Unë jam agjërueshëm." (Sahihul Buhari Muslim)

Duhet që ta lusim Allahun për falje në këtë muaj dhe të bëjmë të gjitha ato që mund t'i bëjmë që të përfitojmë nga kjo kohë e çmuar. Duhet t'i largohemi ndonjë

keqbërjeje kundër agjërimit që do të na asgjësonte të mirat e tij dhe shkaktonë hidhërimin e Zotit, Zoti na ruajt. Prandaj, nuk duhet të jemi mospërfillës ndaj lutjeve tona ose të bëjmë ndonjë koprraci në zekatin tonë.

Nuk duhet të shpenzojmë pjesën e pasurisë së jetimëve, t'ua grabisim pasurinë atyre, ta shtypim dikë, ose të mos i respektojmë prindërit tanë. Nuk duhet t'i shkëputim lidhjet farefisnore. Duhet t'iu shmangemi thashethemeve, përgojimeve, gënjeshtreve, dhe ideve të gabuara. Duhet t'iu shmangemi betimeve të rrejshme dhe pretendimeve. Nuk duhet të rruhemi ose të shkurtojmë mjekrat tona dhe nuk duhet t'i lëmë mustaqet që të rriten. Nuk duhet të dëgjojmë muzikë, apo edhe instrumente muzikore. Gratë nuk duhet të ekspozohen pa shkak, dhe burrat nuk duhet të përzihen me to.

Këto mëkate janë të ndaluara edhe gjatë tërë vitit, por në Ramazan ato bile janë edhe më të ndaluara dhe më të mëdha. Duhet t'i frikësohemi Allahut dhe t'i shmangemi asaj çka Allahu dhe i dërguari i Tij na ka ndaluar. Duhet të jemi të drejtë në bindjen tonë në muajin Ramazan dhe gjatë pjesës tjetër të vitit. Duhet ta ftojme njëri-tjetrin në këtë mirësi, kështu që do të arrijmë suksesin dhe shpëtimin që ky muaj na premtton.

Shejh AbdulAziz ibën Baz
nga anglishtja: Fitim Nuhiu
Redaktoi: O. B.

Kështu duhet zgjedhur shokët

Njerëzit janë krijesa shoqërore nga natyra; ata gjithmonë janë në nevojë të shokëve dhe shoqërisë që e rrethon.

Shumica nga ne jetojnë në varësi bashkëveprimi me të tjerët. Individët e zhvilluar janë bërthama e shoqërisë, diçka

që muslimanët gjithmonë duhet të përpiqen për një gjë të tillë.

Ne të gjithë e dimë se Allahu i Lartësuar na ka sjellur në jetë në mënyrë që të na sprovtojë, kështu që ne jemi këtu për një periudhë relativisht të shkurtë dhe ne do ta takojmë Allahun një Ditë, kështu që ne duhet ta shfrytëzojmë jetën tonë aktuale për atë që është më e mirë për ne, në ahiret. Tani ne e dimë qëllimin dhe synimin tonë në jetë, pra, ne duhet të kërkojmë mënyrat për të arritur ato, kështu që të kemi dobi për vetët tona.

Në një hadith të saktë, i dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, ka thënë: “Njeriu (zakonisht) është në fenë e shokut të tij, kështu që shikoni me kënd po shoqëroheni (miqësoheni)”.

I dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, i cili kishte karakterin më fisnik dhe marrëdhëniet më bujare me njerëzit na dha neve një porosi kaq të qartë dhe një këshillë lidhur me miqësinë.

Si duhet t'i zgjedhim shokët tanë?

Ne duhet ta zgjedhim shokun, të cilit i beson, që pajtohet me fenë tonë (islamit) dhe i bën respekt të madh fesë ashtu siç na ka urdhëruar Allahu dhe Muhamedi, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të.

Ne duhet të qëndrojmë larg atyre të cilët nuk kanë sjellje të mirë dhe nuk e vrasin mendjen se çka është islami ose çka e kënaq Allahun, e çka e hidhëron, kështu që ai sigurisht se do të ndikojë negativisht në ne.

Bazat për veprat e këtyre, të cilët e ndjekin të keqen janë të shkatërruara; veprat e tyre janë të ndërtuara në devijim dhe në drejtim të gabuar. Veprat e tyre janë të pavlera për ata siç thotë Allahu në kur'anin famëlartë: “E Ne i kthehem ndonjë

vepre që e bënë ata dhe e bëjmë atë hi e pluhur.” (Sure Furkan 23)

Veprimet e tyre, bile edhe nëse i shohim si të drejta dhe të shkëlqyera janë të pavlera për ata, kështu që, si mund ata të jenë të dobishëm për ne?

Shokët e mirë janë ata me të cilët e ndan si të mirën ashtu edhe të keqen. Nëse ne i ndajmë ndjenjat tona me keqbërësit, veprat e të cilëve janë të pavlera dhe mbështeten në çoroditje, atëherë ne jemi ndjekësit e rrugëve të njëjta dhe kriterëve të tyre, dhe ne do të përfundojmë si të degjeneruar siç ata janë, dhe atëherë ne jemi në një telashe të madhe. E si mund ta përballojmë pakënaqësinë dhe hidhërimin e Allahut? Zoti na ruajtë .

Në vend që të bëhemi shokë (miq) me dikend që është i paudhëzuar, ne duhet të sillemi me drejtësi me ta, të bëjmë diskutime të lehta dhe me mirësjellje. Qëndrimi në distancë të mjaftueshme është më se e nevojshme; trajtimi i secilit me një sjellje të mirë dhe bujare është e duhur.

Transmetohet nga Ebu Musa el-Esh'arij radijallahu anhu, se Pejgamberi, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të, ka thënë: “Shembulli i ndejës me njerëz të mirë dhe ndejës me njerëz të këqinj është sikurse shitorja e miskut (parfumeria) dhe farka. Shitësi i miskut ose të jep (të eros) ose të shet, ose së paku prej tij kundërmon erë të këndshme. Kurse farkatari ose t'i djeg teshat, ose prej tij do të vjen erë e pakëndshme (nga thëngjilli)”.(Muttefekun alejhi).

Kur t'i zgjedhim shokët tanë ne duhet të pyesim së pari vetët tona: A do të na ndihmojnë ata për të arritur qëllimin se për çfarë jemi krijuar ? Ose do të na largojnë nga ajo?

A do të dëshirojnë për ne kënaqësinë e Allahut ose aspak s'ka të bëjë kjo me interesin e tyre? A do të na shpiejnë ata kah xheneti apo -ruana Zot- kah xhehenemi?

Allahu, subhanehu ue teala, thotë në kur'an : "O ju që besuat, ruane veten tuaj !

Ai që ka humbur, nuk ju dëmton juve kur jeni në rrugë të drejtë. Kthimi i të gjithë juve është tek Allahu dhe Ai ju njohton për atë që vepruat". (Sure El Maide 105)

Marrë nga islamonline.com

Përktheu: Fitim Nuhui

redaktoi: O. B.

Teubeja në Ramazan

Teubeja është detyrë e përhershme në jetën e njeriut, për shkak të nevojës së përhershme që ka njeriu për të në këtë jetë, sepse nuk ndalet së bërit mëkate gjatë jetës së tij. Andaj mëkatet nuk duhet të bëhen shkak që të largojnë nga udhëtimi yt drejt Allahut dhe kthimi kah pendimi. Besimtari nuk duhet të humbë shpresën e as të demoralizohet, sepse Allahu i kë thërritur edhe idhujtarët në pendim, po ashtu edhe zullumçarët edhe kriminelët.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Është e sigurt se ata që i sprovuën besimtarët dhe besimtare dhe nuk u penduan, ata kanë dënimin e Xhehenemit dhe dënimin e Djegies". (El-Buruxh: 10).

Hasan Basriu, rahimehullah, thotë: "Shikoni këtë bujari dhe fisnikëri të Allahut. Ata i kanë vrarë miqtë e Tij, kurse Ai i thërret në pendim dhe falje". (Ibën Kethiri 4/ 60).

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Thuaj: "O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, pse vërtetë Allahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është mëshirues!". (Zumer: 53).

Ibën Kethiri rahimehullah, thotë: "Ibën Abbasi radijallahu anhu, duke e komentuar këtë ajet ka thënë: Allahu subhanehu ue teala, i ka thërritur në falje ata që kanë menduar se Mesihu është Zoti, ata që kanë menduar se Mesihu është i biri i Zotit, ata që kanë menduar se Uzejri është i biri i Zotit, se Allahu është i varfur, ai që mendon se dora e Allahut është e ndrydhur, ata që mendojnë se Allahu është treshi. Këtyre njerëzve u thotë:

"E pse të mos pendohen dhe të kërkojnë te Allahu falje, kur Allahu dihet se falë shumë, është mëshirues?". (El-Maide: 74).

Urdhëro, o kërkues i së mirës

Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sellem, ka thënë: "Natën e parë të muajit Ramazan prangosen shejtanët dhe xhinët e inatosur, mbyllen dyert e xhehenemit, dhe nuk hapet asnjë derë, hapen dyert e xhenetit dhe nuk mbyllet asnjë derë. Thërret një thirrës: o kërkues i së mirës urdhëro, kurse ti o kërkues i të keqes ngurro. Allahu në çdo natë ka njerëz që i liron nga zjarri i xhehenemit". (Tirmidhiu, hasen).

Ebu Hurejre radijallahu anhu, tregon se Pejgamberi, salallahu alejhi ve sellem,

duke hipë në minber tha: "Amin, amin, amin. I thanë: o i Dërguar i Allahut duke hipur në minber të dëgjuam duke thënë: amin, amin, amin. Tha: "Më erdhi Xhibrili, alejhi selam, e më tha: cili e takon Ramazanin e nuk i falen mëkatet dhe hyn në xhehenem, e largoftë Allahu, thuaj amin, e unë thash: amin". (Ahmedi, sahih).

Po, na ka ardhur ky muaj i bekuar, edhe ti, nisu kah Zoti, ndaj të cilit ke bërë mëkate, i përlur, i penduar, duke qarë e thuaj:

O Zot i gjithësisë, unë u pendova

O Ti që jep të mira, me jep udhëzimin

Sepse po s'patëm udhëzim, asgjë s'na bën dobi

Rrëshqitjet e mia pranoi me falje, butësi dhe mëshirë

Sepse askush përveç Teje kështu nuk vepron.

Vëlla i dashur!

Nëse nuk të falen mëkatet në këtë muaj, nëse në këtë muaj nuk të lotojnë sytë, nëse zemra jote para Zotit tënd nuk përulet në këtë muaj, vallë kur do të ndodh kjo gjë?!

Vëlla, a nuk të kanë lotuar sytë nga frika prej Allahut asnjë herë?

A nuk e ndien se zemra jote është afër Allahut në këtë muaj?

A nuk mendon se është mundësi e madhe që të shtosh adhurimet dhe frikërespektin, pendimin dhe përlësinë në këtë muaj?

Le të jetë ky muaj fillimi i pendimit të sinqertë dhe të vërtetë para Allahut subhanehu ue teala, vepër me të cilën do të shtojmë kontaktin tonë me Allahun subhanehu ue teala. Allahu, tebareke ve teala, thotë:

"Kurse ata që e gjetën rrugën e drejtë, Ai atyre u shton edhe më udhëzimin në rrugën e drejtë dhe u ofron mundësi të jenë edhe më të matur". (Muhammed: 17).

O njeri!

Ja, Allahu, subhanehu ue teala, na qorton duke na thënë:

"O njeri, po ç'të mashtroi ty kundrejt Zotit tënd që është bujar e i urtë?". (El-Infitar: 6).

Po. O njeri, çka të mashtroi që të kalosh kufijtë që i ka caktuar Allahu dhe të bësh mëkate ndaj Tij?!

Vallë i injoron dhuntitë e Tij?!

Ose ke harruar kontrollin dhe Madhërinë e Tij?!

Është thënë:

"Unë jam ai që e mbylli derën për

Ti fshehur mëkate e mija që i bëj

Kurse Syri i Zotit vazhdimisht më shikon

Sa i butë është Allahu, që më jep afat

Unë vazhdoj të bëjë mëkate, kurse Ai mua më mbulon".

Vëlla, mos shiko sasinë e mëkatit, por shiko Madhërinë e Atij që i bën mëkat.

Vëlla, aq sa kujdesesh për shikimet e njerëzve ndaj Teje, aq më tepër kujdesu për Shikimin e Allahut ndaj teje.

Ka myzhde për ty

Ja po të ofroj myzhde nga Zoti dhe Pejgamberi yt.

Allahu subhanehu ue teala, thotë:

"Thuaj: "O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut, pse vërtetë Allahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është mëshirues!". (Ez-Zumer: 53).

Dhe thotë: “Edhe ata që pos Allahut, nuk lusin zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që e ka ndaluar Allahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto, ai gjen ndëshkimin. Atij i dyfishohet dënimi ditën e kiametit dhe aty mbetet i përbuzur përgjithmonë. Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepër të mirë, të tillëve Allahu të këqijat ua shndërron në të mira. Allahu është mëshirues, ndaj Ai falë shumë”. (El-Furkan: 68- 70).

Sa dhunti e madhe dhe sa fitim i madh.

Allahu subhanehu ue teala, i zëvendëson të këqijat dhe i bën të mira. Allahu ekber!

Këtë fitim nuk e le pas dore askush tjetër përveç injorantit ose atij që nuk i dëshiron dhuntitë.

Pra, vëlla i dashur pendohu, nëse i dëshiron këto të mira. Nëse dëshiron që mëkatet të të shndërrohen në vepra të mira.

Dëgjo se çka thotë Pejgamberi, salAllahu alejhi ve selem:

“Allahu më shumë gëzohet me pendimin e robit të Tij se sa njeriu që gjendet në shkretëtirë, të cilit i ka humbur deveja, në të cilën e ka pasur ushqimin e tij dhe më vonë e gjen”. (Buhariu dhe Muslimi).

Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve selem, thotë se Allahu ka thënë:

“O biri i Ademit! Nëse më lutesh dhe më shpreson, t'i fali mëkatet që i ke bërë dhe nuk më intereson asgjë më tepër. Biri i Ademit, nëse mëkatet tuaja arrijnë kupën e qiellit, e pastaj ti kërkon falje, t'i fali mëkatet dhe nuk më intereson asgjë”. (Buhariu dhe Muslimi).

Allahu thotë:

“O robërit e Mi! Ju bëni mëkate gjatë natës dhe gjatë ditës, kurse unë ua fali të gjitha mëkatet, andaj kërkoni falje, që tua fali”.

Resulullahu, alejhi selam thotë:

“Allahu e shtrin Dorën gjatë natës që të pendohet ai që ka bërë gabime gjatë ditës dhe e shtrinë Dorën gjatë ditës që të pendohet ai që ka bërë mëkate gjatë natës. Kështu vazhdon deri sa të del dielli nga perëndimi i tij”. (Muslimi).

Kur e pa Resulullahu, alejhi selam një grua duke e kërkuar fëmijën e saj në mesin e njerëzve të zënë rob, dhe kur e pa e përqafoi dhe e shtrëngoi për gjoksi tha: “A mendoni se kjo mundet ta hedh fëmijën e saj në zjarr? Thanë: Jo. Tha: “Allahu është edhe më i mëshirshëm se kjo grua ndaj fëmijës së saj”.

Allahu ekber!

A nuk mjaftojnë këto hadithe që të na nxisin për pendim dhe kërkim të faljes!

A nuk është e madhe kjo bujari që të na stimulojë në pendim!

I lartësuar qoftë Allahu sa i mëshirshëm, sa i butë dhe sa Bujar që është!

Është thënë:

"Pasi mu ngurtësua zemra dhe më ngushtuan rrugët

Shpresën time ndaj Teje e kam bërë shkallë për te falja Jote

Mëkati im mu duk shumë i madh

Mirëpo kur e krahasova me faljen tënde, falja Jote ishte edhe më e madhe

Edhe më tej je Falës i mëkateve

Bujar dhe Falës, dhuratë dhe nderim".

Bëhu i çelur me vetveten!

Çka të ndalon nga pendimi dhe rruga e përmirësimit?!

Ndoshta thua: familja, shoqëria dhe shokët!

Ose frikësohem të pendohem e të kthehem sërish në mëkatet e vjetra!

Kam shumë mëkate, e si ka mundësi që Allahu të mi fal të gjitha mëkatet!

Kam frikë për familjen dhe pasurinë time!

Unë përgjigjem: vallë, do t'i thuash këto fjalë para Allahut subhanehu ue teala,?

Dije se këto janë pengesa të imagjinuara dhe të cilat i thyen frika nga Allahu subhanehu ue teala,.

Nëse shpirtat janë të mëdhenj

Lodhet trupi në realizimin e aspiratave të tyre

Bëhu krenar me fenë tënde. Bëhu i vendosur për të bërë punë të mira dhe për të vazhduar në këto të mira. Mbështetu në Allahun, e pastaj kujto mëshirën e Allahut dhe gjerësinë e Faljes së Tij.

Vëllai im. Nëse në këto çaste të vjen meleku i vdekjes, a do të ishe i kënaqur që ta takosh Allahun në këtë gjendje?!

Vëlla, mos ik nga vetvetja dhe llogaria e saj, nëse nuk e llogarit sot, do ta llogaritësh nesër, nesër do të pendohesh, mirëpo do të jetë vonë, sepse atë ditë nuk bën dobi pendimi.

Lindje e re

Dije se pendimi nuk është i veçantë vetëm për këtë muaj, por vazhdon edhe për muajt tjerë. Mirëpo ndoshta në këtë muaj të bekuar është lindja jote e re. Njeriu mund të lindë dy herë: atë ditë kur të del nga errësira e barkut të nënës dhe atë ditë që del nga errësira e mëkateve në dritën e adhurimeve.

Miku im!

Shoqërohu me njerëz të mirë të cilët të bëjnë dobi edhe pas vdekjes tënde, duke u lutur për ty. Rri dhe shoqërohu me ta. Duro me ta deri në momentin kur do të udhëtosh te Zoti yt, atëherë kur do të thuhet:

“(u thonë) Selamun alejkum, me durimin tuaj gjetët shpëtimin; sa përfundim i lavdishëm është ky vend”. (Er-Rad: 24).

Kujdesu se çfarë njerëz ke zgjedhur për shokë, a do të jenë ata që do të luten për ty siç i ka mësuar Allahu myslimanët të luten për vëllezërit e tyre duke thënë:

“Edhe ata që kanë ardhur pas tyre e thonë: "Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë që para nesh u pajisën me besim dhe mos lejo në zemrat tona farë urrejtjeje ndaj atyre që besuan. Zoti ynë Ti je i butë, mëshirues!". (El-Hashr: 10).

Ose do të bëhesh nga ata që kur do të dalin para Allahut do të thonë:

“Atë ditë zullumqari do t'i kafshojë duart e veta dhe do të thotë: "I mjeri unë, ta kisha marrë rrugën e Pejgamberit!" O shkatërrimi im, ah të mos e kisha bërë filanin mik! Në të vërtetë, pasi e gjeta rrugën e drejtë, ai më largoi mua prej asaj, e djalli është ai që njeriun e humb dhe e lë të vetmuar”. (El-Furkan: 27- 29).

Para se të mbyllet dera

Vëlla i dashur!

Tani, para se të mbyllet dera përcakto rrugën në të cilën do të ecësh dhe metodën e cila të udhëheqë në jetën e kësaj dhe asaj bote.

Sa gëzim dhe lumturi e madhe e kaplon zemrën e besimtarit kur kthehet te Allahu me pendim dhe të futet në karvanin e burrave të devotshëm...vallahi është

lumturi të cilën nuk e ka shijuar askush tjetër përveç atij që e ka përjetuar.

Vëlla...nëse ke vendosur të pendohesh dhe të kthehesh...të nënshtrohesh dhe përulësh...dije se pendimi i ka disa kushte të domosdoshme:

1- keqardhja për atë që ke bërë.

2- largim nga mëkati.

3- vendosje që mos të kthehet në atë mëkat. E nëse kthehesh përsërite pendimin...mirëpo me vendosmëri.

4- pendohu para se të vjen shpirti në fyt dhe para se të del dielli nga perëndimi.

Një lutje

Allahu im, Ty të takon i tërë falënderimi, Ti më ke krijuar, më ke furnizuar dhe më ke bërë mysliman.

Allahu im, qofsh i Lartësuar, të kam bërë mëkat me dhuntitë e Tuaja, i Lartësuar qofsh, të kam kundërshtuar edhe pse je Madhështor.

Allahu im, nëse nuk më fal Ti, kush do të më falë mëkatet? Nëse nuk më mëshiron, kush do të më mëshirojë?!

Allahu im, nuk kam Zot tjetër të cilin do ta lus dhe do ta shpresoj.

Allahu im, po kthehem dhe pendohem te Ti, me mëshirën, faljen dhe butësinë Tënde mos më refuzo. Më prano, o Ti që e pranon pendimin nga robërit dhe i fal gabimet.

Allahu im, sado që janë të mëdha mëkatet, mëshira Jote është edhe më e madhe, sado që janë të mëdha gabimet, Ti i fal të gjitha gabimet.

Allahu im, i kam bërë padrejtësi të madhe vetvetes, kurse askush përveç Teje nuk i fal mëkatet, më fal me falje prej Teje dhe më mëshiro, sepse Ti je Falësi dhe i Mëshirshmi.

Allahu im na kthe te Ti në mënyrën më të mirë...me mëshirën Tënde, o më i Mëshirshmi i mëshiruesve. Amin.

përgatiti: Bekir HALIMI

Konfrontimi mes njeriut dhe shejtanit

Ky konfrontim ka filluar në Xhennet nga dita kur shejtani refuzoi t'i nënshtrohet urdhrorit të Zotit subhanehu ve teala, që t'i përulet Ademiti alejhi selam. Si rezultat i këtij refuzimi, Allahu e përzuri nga mëshira e Tij dhe e mallkoi. Ai u betua para Allahut se do ta shmangë nga rruga e drejtë atë dhe pasardhësit e tij.

“Ai tha: "Pasha madhërinë Tënde, kam për t'i shmangur prej rrugës së drejtë që të gjithë,...". (Sad: 82).

Hapi i parë ishte lajthitja e prindërve të njerëzimit, në të cilin hap shejtani arriti sukses dhe i nxori nga Xhenneti.

“(Allahu) tha: "Zbritni, jeni armik i njërit-tjetrit. Në tokë ju e keni vendqëndrimin (vendbanimin) dhe përjetim deri në një kohë". (El-A'raf: 24).

Zbriti Ademi alejhi selam në tokë që të ballafaqohet ai dhe pasardhësit e tij me shejtanin, kurthet e tij dhe luftën për të lajthitur njerëzimin. Në këtë betejë shejtani është armatosur me lloj-lloj arme, siç janë:

1- Mundësia për t'i zbukuruar gjërat dhe për t'i devijuar ato.

“(Iblisi) Tha: "Zoti im, për shkak që më përzune (më largove), unë do t'ua zbukurojë (të këqijat) atyre sa të jenë në tokë (në këtë botë) dhe të gjithë ata do t'i largojë nga rruga e drejtë!". (El-Hixhr: 39).

“Pasha Allahun, Ne dërguam edhe para teje të dërguar ndër popuj, po veprat e tyre (të këqija) ua hijeshoi djalli, se ai është mik i tyre, e ata kanë një dënim të idhët”. (En-Nahl: 63).

2- Gënjeshtria dhe mashtrimi.

“Shejtani i nixti ata të dy (i mashtroi), që t'ua zbulojë atyre pjesët e turpshme që u ishin të mbuluara dhe tha: "Zoti juaj nuk ua ndaloi ju dyve atë pemë vetëm që të mos bëhi melekë (engjëj), ose të mos bëheni prej të përjetshmëve. Dhe ju bëri be atyre (duke u thënë) se: unë jam këshillues për ju”. (El-A'raf: 20- 21).

“Ai u premtonte atyre dhe i bën të shpresojnë, por djalli nuk premtonte tjetër vetëm se mashtrim”. (En-Nisa: 120).

“Djalli ju frikëson nga varfëria dhe ju urdhëron për të këqija, e Allahu ju garanton falje (mëkatesh) e begati; Allahu është Dhurues i Madh, i Dijshëm”. (El-Bekare: 268).

3- Ky armik na sheh, kurse ne nuk e shohim.

“Vërtetë ai dhe shoqëria e tij ju sheh, ndërsa ju nuk e shihni. Ne i kemi bërë shejtanët miq të atyre që nuk besojnë”. (El-A'raf: 27).

Qarkullon nëpër damarët tonë të gjakut.

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, thotë: “Shejtani qarkullon te njeriu nëpër damarët e tij të gjakut”. (Buhariu dhe Muslimi).

4- Mundësi e tij të mësojë disa gjëra të fshehta e t'ua tregojë miqve të vet.

Aisheja, radijallahu anha, tregon se ka dëgjuar Pejgamberin salallahu alejhi ue selem, duke thënë: “Melaqet zbresin në re dhe i përmendin gjërat që janë caktuar në qiell, kurse shejtanët i përvjedhin këto lajme

e ua tregojnë fallxhorëve, e kësaj të vërtete ata ia shtojnë edhe njëqind gënjeshtër”. (Buhariu dhe Muslimi).

Mirëpo sërish kurthet e shejtanit janë të dobëta.

“Luftoni pra miqtë e djallit, s'ka dyshim se intriga e është e dobët”. (En-Nisa: 76).

Kjo ndodh kur muslimani i mbështetet Zotit të vet dhe kapet për besimin e Tij.

Qëllimi dhe synimet e shejtanit

Qëllimi përfundimtar i shejtanit është që ta shoh njeriun në zjarr të Xhehennemit, siç na tregon Allahu subhanehu ve teala,: “Djali është armik i juaji, pra edhe ju konsideroni armik, ai e thërret atë grupin e vet, vetëm për t'i bërë banues të zjarrit”. (Fatir: 6).

“E djalli dëshiron t'i humbë në pafundësi”. (En-Nisa: 60).

E nëse e arrinë këtë qëllim dhe nuk arrinë t'i bëjë mbarë njerëzit pabesimtarë, ai nuk dëshpërohet, por dakordohet me disa mëkate dhe lajthitje.

Sebure ibn Fakihe tregon se ka dëgjuar Pejgamberin salallahu alejhi ue selem, duke thënë: “Shejtani i del birit të Ademit në çdo rrugë përpara. I del në rrugën e tij të Islamit e i thotë: po bëhesh musliman dhe po e le fenë e prindërve, gjyshërve dhe stërgjyshërve. Ky nuk e dëgjon dhe bëhet musliman. Pastaj i del në rrugën e tij të shpërnguljes e i thotë: po shpërngulesh dhe po e lë tokën dhe qiellin tënd. Shembulli i shtegtarit është sikurse shembulli i kalit në gjatësi, ky nuk e respektoi dhe u shpërngul. Pastaj i del në rrugën e tij të xhihadit dhe i thotë: do të dalish në luftë, e lufta është harxhim i energjisë dhe pasurisë, do të luftosh dhe do vritesh, e të martohet gruaja dhe të ndahet pasuria. Ky nuk e respektoi dhe shkoi në luftë. Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, tha: “Kush e bën këtë Allahu

e ka obligim që ta fusë në xhennet. Kush vritet Allahu e ka obligim që ta fusë në Xhennet, kush fundoset Allahu e ka obligim që ta fusë në Xhennet ose e rrëzon kafsha, Allahu e ka obligim që ta fusë në Xhennet”. (sahih, Nesaiu dhe Ahmedi).

Njeriu pyetet vallë sa është i suksesshëm shejtani në qëllimet dhe synimet e veta. Përgjigjja është e tillë që e trishton njeriun. Prej një mijëve vetëm një shpëton.

Ebu Seid Hudriu, radijallahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Allahu thotë: “Adem! I përgjigjet: të përgjigjem i lumtur, kurse çdo e mirë është në duar Tuaja. I thotë: nxjerre grupin e Xhehennemit. I tha cili është grupi i Xhehennemit? Tha: nga çdo një mijë veta nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë persona. Atëherë thinjet i vogli, çdo grua shtatzënë e nxjerr foshnjen e saj, i shoh njerëzit si të dehur, edhe pse ata nuk janë të dehur, mirëpo denimi i Allahut është shumë i rëndë”. (Buhariu).

Disa forma të kurthës së shejtanit kundër njeriut

Beteja e shejtanit me njeriun fillon që nga lindja.

Ebu Hurejre, radijallahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Secila foshnje që lindë e ngacmon shejtani, përveç Isait dhe nënës së tij”. Pastaj Ebu Hurejre, radijAllahu anhu, tha: lexoni nëse doni: “...e atë dhe pasardhësit e saj po t'i lë Ty në mbrojtje prej djallit të mallkuar”. (Ali Imran: 36)”. (Buhariu dhe Muslimi).

Ebu Hurejre, radijAllahu anhu, tregon dhe thotë: “Britma e fëmijës kur lindë është nga ngacmimi i shejtanit”. (Muslimi).

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, na ka treguar lutje me të cilat i mbrojmë fëmijët tanë, madje para se të lindin.

Ibn Abasi, radijAllahu anhu tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Po qe se keni kontakt me gruan tuaj thoni: "Bismil-lah, Allahumme xhenibnash-Shejtane ve xhenibishejtane ma rezektena-në Emër të Allahut, Allahu ynë na e largo shejtanin prej nesh dhe na e largo shejtanin nga ajo që na e furnizon", e nëse nga ajo natë lind fëmijë, nuk mundet ta dëmtojë asgjë". (Buhariu dhe Muslimi).

Gjatë jetës së njeriut vazhdojnë format e kurthës së shejtanit kundër njeriut në shumë gjendje.

Xhabiri radijAllahu anhu, tregon se ka dëgjuar Pejgamberin salallahu alejhi ue selem, duke thënë: "Shejtani është i pranishëm në çdo gjë prej çështjeve të tij". (Muslimi).

1- Në namaz.

Aisheja, radijAllahu anha, e ka pyetur Pejgamberin salallahu alejhi ue selem, për shikimin djathtas dhe majtas në namaz, e ai i është përgjigjur: "Vjedhje të cilën e bën shejtani nga namazi i një besimtari". (Buhariu).

Ebu Hurejre radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Kur të thirret ezani për në namaz, ikë shejtani duke pordhur, që mos ta dëgjojë ezanin, e kur të përfundojë ezani kthehet. Kurse kur të thirret ikameti ikë e kur të përfundojë kthehet sërish, saqë qëndron mes njeriut dhe vetvetes duke i sjellë mendime: përkujto këtë e këtë, gjëra të cilat nuk i ka përkujtuar aspak, derisa mos të dijë njeriu se sa rekate ka falur". (Buhariu dhe Muslimi).

Ebu Hurejre radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka

thënë: "Kur ndokush prej jush ngritet të falë namaz i vjen shejtani dhe ia pështjellon saqë nuk di se sa ka falur. Nëse e gjenë këtë ndonjëri prej jush, le ti bëjë dy sexhde duke qenë ulur". (Tirmidhiu).

Enes ibn Maliku radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Mbushni rreshtat (safat), afroni mes tyre, barazoni qafat, sepse pasha Atë në Dorë të të Cilit është shpirti im, e shoh shejtanin se si hyn mes safeve, si të jetë edh". (Nesaiu dhe Ebu Davudi).

Ebul-Ala tregon se Othman ibën Asi ka shkuar te Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, dhe e ka pyetur: O i Dërguar i Allahut, shejtani më pengon në namaz dhe në lexim, atëherë Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, tha: "Ai është shejtani i cili quhet hinzeb, nëse e ndien këtë gjë, kërko strehim te Zoti prej Tij dhe pështyje në të majtë tre herë". Tha: kështu veprova, kurse Allahu e largoi prej meje këtë ngacmim. (Muslimi dhe Ahmedi).

Abdull-llah ibn Omeri radijAllahu anhu, e pa një njeri duke luajtur me një guralec në namaz. Kur e kreu namazin i tha: "Moz e lëviz guralecin duke qenë në namaz, sepse kjo është prej shejtanit, por vepro ashtu si ka vepruar Pejgamberi. Tha: si ka vepruar Pejgamberi salallahu alejhi ue selem,? Tha: e vëndonte dorën e djathtë mbi kofshën e djathtë, kurse me gishtin tregues tregonte në drejtim të kibles dhe e shikonte me sy. Tha: kështu e kam parë Pejgamberin salallahu alejhi ue selem, duke vepruar". (Nesaiu).

2- Përtacia dhe përtesa.

Ebu Hurejre radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Hapja e gojës është prej shejtanit, nëse i hapet goja le ta refuzojë sa të ketë

mundësi, sepse po tha: ha, qeshet me të shejtani”. (Buhariu).

Ebu Hurejre radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Allahu e do teshtitjen dhe e urren hapjen e gojës. Nëse ndonjëri prej jush kur të teshtitet e falënderon Allahun, secili musliman që e dëgjon këtë duhet t’i thotë: “jerhamukall-llah”. Kurse hapja e gojës është prej shejtanit andaj le ta refuzojë sa të mundet, se po qe se tha: ha, qeshet me të shejtani”. (Buhariu).

3- Shejtani mundohet ta zotërojë edhe para gjumit edhe gjatë gjumit.

Ebu Hurejre radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Shejtani secilit prej jush kur të bien të flejë ia lidhë tre nyje dhe në secilën nyje thotë: bëfsh gjumë të thellë. E nëse zgjohet dhe e përmend Allahun, zgjidhet një nyje, nëse merr abdest zgjidhet edhe nyja tjetër, e nëse falet zgjidhet edhe nyja e tretë, andaj zgjohet i gjallë dhe shpirtëmirë, përndryshe shpirtkeq dhe përtac”. (Buhariu dhe Muslimi).

Ebu Katadeja radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Ëndrra e mirë është prej Allahut, kurse e keqja është prej shejtanit. E nëse ndokush sheh ëndërr që e frikëson le të pështyje në të majtë tre herë dhe le të kërkojë strehim prej Allahut nga e keqja e saj, se ajo nuk mundet ta dëmtojë”. (Buhariu dhe Muslimi).

Një bediun erdhi dhe i tregoi Pejgamberit salallahu alejhi ue selem, një ëndërr, ku e kishte parë veten me kokë të këputur dhe duke vrapuar pas kokës së tij. Atëherë Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ia tërhoqi vërejtjen duke i thënë: “Mos trego lojën e shejtanit me ty në ëndërr”. (Muslimi).

Ebu Hurejre radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Kur ndonjëri prej jush zgjohet prej gjumit e të merr abdest le të shpërlajë hundën tre herë, sepse shejtani flenë në hundën e tij”. (Buhariu dhe Muslimi).

Nga shkak i nyjeve të shejtanit muslimanit i ikë namazi i natës.

Një herë te Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, e përmendën një njeri i cili tërë natën ka fjetur, nuk është falur deri në namaz të sabahut. Atëherë Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Këtë e ka përmjerrë shejtani në vesh”. (Buhariu dhe Muslimi).

4- Shejtani bën kurthe edhe në ushqim dhe pije.

Xhabiri radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Kur njeriu hynë në shtëpi dhe e përmend Allahun kur të hyjë dhe kur të fillon ngrënien, shejtani thotë: nuk keni vend për fjetje e as ushqim, e nëse hynë në shtëpi dhe nuk e përmend emrin e Allahut gjatë hyrjes, shejtani u thotë: keni gjetur vend për fjetje, e kur nuk e përmend emrin e Allahut gjatë ngrënies, shejtani thotë: keni gjetur edhe vend për fjetje edhe ushqim”. (Muslimi).

5- Në treg.

Selmani radijAllahu anhu, thotë: “Mos u bë i pari që hynë në treg e as i fundit që del prej tregut. Sepse aty është vendi i betejës së shejtanit dhe aty e ngritë flamurin e vet”. (Muslimi).

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “O ju tregtarë! Shejtani dhe mëkati janë të pranishëm në shitblerje, andaj ngjyrosni shitblerjen tuaj me vërtetësi”. (Tirmidhiu dhe Nesai).

6- Vazhdon kurtha e shjtanit kundër njeriut deri në çastet e fundit të jetës.

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, na ka mësuar lutje që na mbrojnë edhe në këtë gjendje.

Ebul-Jusri tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Allahu im, kërkoj mbrojtje prej Teje që mos të rrëzohem (e të mbytem), mos të më zënë gërmadhat, mos të fundosem, mos të digjem. Kërkoj mbrojtje prej Teje që mos të më devijojë djalli duke dhënë shpirt. Kërkoj mbrojtje prej Teje që të vdes në rrugën Tënde duke u tërhequr dhe kërkoj strehim te Ti që mos të vdes i kafshuar (prej kafshëve helmuese)". Hadithi është sahih, transmeton Nesaiu.

Gjërat që e shpëtojnë njeriun nga kurthet e shejtanit

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, na i ka treguar gjërat që na mbrojnë nga kurthet e shejtanit dhe nga e keqja e tij, prej tyre janë:

1- Singëriteti.

"(Iblisi) Tha: "Zoti im, për shkak që më përzune (më largove), unë do t'ua zbukurojë (të këqiat) atyre sa të jenë në tokë (në këtë botë) dhe të gjithë ata do t'i largojë nga rruga e drejtë!" Përveç robërve të Tu, të cilët i ke bërë të sinqertë". (El-Hixhr: 39- 40).

Pra, shejtani na lajmëroi se robërit e sinqertë do të shpëtojnë.

2- Adhurimi i mirë.

"Se ndaj robëve të Mi (të sinqertë) nuk ke kurrfarë force (as fizike as mendore), përveç atyre të humburve që vijnë pas teje". (El-Hixhr: 42).

3- Kërkim i strehimit nga Allahu dhe mbrojtje me Madhërinë e Tij.

"E nëse të godet shejtani me ndonjë vesvese, ti kërko strehim te Allahu, sepse vërtet Ai dëgjon e di". (El-A'raf: 200).

Kërkimi i strehimit nga Allahu është i ligjshëm në çdo rast edhe pse në disa raste është me i preferuar, siç janë:

a) Gjatë trishtimit.

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, i mësonte sahabet t'i thonë këto fjalë gjatë trishtimit: "Kërkoj strehim te Fjalët e Allahut të plota nga Hidhërimi i Tij, e keqja e robërve të Tij dhe nga ngacmimet e shejtanit ose prania e tij". (Tirmidhiu dhe Ebu Davudi).

b) Gjatë daljes nga shtëpia.

Enes ibn Maliku radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Kur të del njeriu prej shtëpisë e të thotë: bismil-lah, tevekeltu alall-llah, ve la havle ve la kuvvete il-la bil-lah- në Emër të Allahut, Allahut i mbështetem, s'ka mundësi e forcë vetëm se me Allahun, atëherë i thuhet: qofsh i udhëzuar, i mjaftuar dhe i ruajtur, atëherë largohen shejtanët dhe i thonë njëri-tjetrit: çka mund t'i bësh njeriut i cili është i udhëzuar, i mjaftuar dhe i ruajtur". (Ebu Davudi dhe Tirmidhiu).

c) Gjatë hyrjes në xhami.

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, kur hynte në xhami thoshte: "Kërkoj strehim te Allahu i Madh, me Fytyrën e Tij Fisnike, Pushtetin e Tij të vjetër nga shejtani i mallkuar". Tha a për çdo herë? Tha: po, kur ta thotë njeriu këtë, shejtani thotë: është mbrojtur prej meje tërë ditën". (Ebu Davudi).

ç) Gjatë leximit të Kur'anit.

Allahu subhanehu ve teala, thotë: "Kur të lexosh Kur'anin kërko mbrojtjen e Allahut prej djallit të mallkuar". (En-Nahl: 98).

d) Gjatë hyrjes në nevojtoje.

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, kur hynte në nevojtoje thoshte: "Allahu im, strehohem te Ti nga shejtanët meshkuj dhe femra". (Buhariu dhe Muslimi).

dh) Gjatë hidhërimit.

Sulejman ibn Serdi radijAllahu anhu, tregon dhe thotë: Isha ulur me Pejgamberin salallahu alejhi ue selem, kurse dy persona shaheshin mes vete, e njërit iu skuq fytyra dhe iu frynë damarët.

Atëherë Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, tha: "Unë di një fjalë nëse e thotë i kalon ajo që e ndien. Po të thoshte: strehohem te Allahu nga shejtani, do t'i kalojë ajo që e ndien. I thanë: Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, tha: Kërko strehim nga Allahu prej shejtanit. Kurse ai tha: nuk jam i çmendur!". (Buhariu).

e) Kur të dëgjosh palljen e gomarit.

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Kur të dëgjoni këndimin e gjelit, kërkoni nga të mirat e Zotit, sepse ai ka parë melaqe, kurse kur të dëgjoni palljen e gomarit, kërkoni strehim te Allahu nga shejtani, sepse ai e ka parë shejtanin". (Buhariu dhe Muslimi).

ë) Në namaz.

Xhubejr ibn Matami thotë se ka parë Pejgamberin salallahu alejhi ue selem, duke u falur namaz. E filloi namazin me fjalët: "Allahu ekber kebiren, tre herë, elhamudlilahi kethiren, tre herë dhe subhanall-llahi bukreten ve esila, tre herë. Pastaj tha: kërkoj strehim te Allahu nga shejtani, mendjemadhësia, poezia dhe ngacmimet e tij". (Tirmidhiu dhe Ebu Davudi).

4- Leximi i Kur'anit.

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Mos i bëni shtëpitë e juaja varreza, sepse shtëpia ku lexohet surja Bekare, nuk hyn shejtani". (Muslimi).

Abdull-llah ibn Mes'udi radijAllahu anhu, thotë: "Kush i lexon katër ajetet e para të sures Bekare, ajetul-Kursinë, dy ajete pas ajeti kursisë, tre ajetet e fundit të sures Bekare, nuk i afrohet atë ditë shejtani as tij

e as familjes së tij, po as ndonjë e keqe. Nëse ia lexojnë ndonjë të sëmuri shërohet". (Darimiu).

5- Përmendja e Allahut.

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, thotë: "Kush thotë: la ilahe il-lal-llah vahdehu la sherike lehu lehul-mulku ve lehul-hamdu ve huve ala kul-li shejin kadir gjatë ditës një qind herë, i vlen si të kishte liru ar dhjetë robër, i shkruhen një qind të mira, i shlyhen një qind të këqija dhe i bëhen mbrojtje nga shejtani tërë ditën deri në mbrëmje. Askush nuk vjen me punë më të mirë përveç atij që bën më shumë se ky". (Buhariu dhe Muslimi).

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Kur të vjen mbrëmja largoni fëmijët (nga rruga) sepse përhapen shejtanët, e kur të kalon pjesa e parë e natës lejoni, mbyllni dyert dhe përmendni Emrin e Allahut, sepse shejtani nuk e hap derën e mbyllur". (Buhariu dhe Muslimi).

6- Abdesi.

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, thotë: "Shejtani secilit prej jush kur të bien të flejë ia lidhë tre nyje dhe në secilën nyje thotë: bëfsh gjumë të thellë. E nëse zgjohet dhe e përmend Allahun, zgjidhet një nyje, nëse merr abdest zgjidhet edhe nyja tjetër, e nëse falet zgjidhet edhe nyja e tretë, andaj zgjohet i gjallë dhe shpirtmirë, përndryshe shpirtkeq dhe përtac". (Buhariu dhe Muslimi).

7- Përmbajtja e xhematit.

Midan ibn Ebi Talha tregon: Një herë Ebu Derda radijAllahu anhu, më tha: Ku banon? I thashë: Në fshatin Devin të Himsit. Ai më tha: Kam dëgjuar Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, duke thënë: "Nëse në një fshat ose fushë gjenden tre veta, e nuk falin namaz, i ngërthen shejtani. Përmbajuni xhematit, sepse ujku e han delen e ndarë". (d.m.th

namazit me xhemat). (Nesaiu dhe Ebu Davudi).

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, kur ndalej ndokund të pushonte, shokët e tij ndaheshin nëpër kodrina dhe lugina, andaj thoshte: “Kjo shpërndarje e juaj nëpër kodrina dhe lugina është prej shejtanit”. Pastaj aq shumë mblidheshim njëri afër tjetrit saqë po të hedhnin një pëlhurë mbi ne do të na mbulonte. (Ebu Davudi dhe Ahmedi).

Ibën Omeri radijAllahu anhu, tregon: Omeri radijAllahu anhu, na e mbajti një hutbe në Xhabije, mes tjerash tha: “O ju njerëz, kapuni për bashkësinë dhe keni dro përçarjen, sepse shejtani është me një, kurse është më larg prej dy muslimanëve. Ai që dëshiron gjerësinë e Xhennetit, le të kapet për xhemat”. (Tirmidhiu dhe Ahmedi).

Veglat e shejtanit në lajthitjen e njeriut

Shejtani posedon vegla dhe delegatë të cilët i ndihmojnë kundër njeriut, siç janë:

1- Hidhërimi.

Sulejman ibn Serdi radijAllahu anhu, tregon: Isha ulur me Pejgamberin salallahu alejhi ue selem,, kurse ndërkohë dy persona u shanë mes vete, e njërit iu skuq fytyra dhe iu frynë damarët. Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, tha: “Unë di një fjalë, nëse e thua ta largon këtë hidhërim: po të thoshte: eudhu bil-lahi minesh-shejtanim-raxhim (strehohem te Allahu nga shejtani) do t'i kalonte”. I thanë se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë kërko strehim te Allahu nga shejtani. Kurse ai u përgjigj: vallë mos jam i sëmurë”. (Buhariu).

Atije radijAllahu anhu, thotë se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Hidhërimi është prej shejtanit, kurse shejtani është krijuar nga zjarri, e zjarri shuhet me ujë, andaj kur të hidhërohet

ndonjëri prej jush le të merr abdest”. (Ebu Davudi dhe Ahmedi).

Hidhërimi është mjet për tu zënë njerëzit mes vete dhe për tu përçarë, kurse ky është qëllimi i shejtanit.

Allahu subhanehu ve teala, thotë: “O ju që besuat, s'ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar. Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedh armiqësi mes jush, t'ju pengojë nga të përmendurit e Zotit dhe t'ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?”. (El-Maide: 90- 91).

“E ti robve të Mi thuaju: "Le ta thonë ata që është më e mira, pse djalli ndërren mes tyre, e është e ditur se djalli është armik i hapët i njeriut". (El-Isra: 53).

Prej ndërsimeve të tij është edhe atë që e bëri mes Jusufit alejhi selam dhe vëllezërve të tij: “...e juve u solli nga fshati pasi djalli pat futur përçarje ndërmjet meje dhe vëllezërve të mij”. (Jusuf: 100).

Xhabiri radijAllahu anhu, thotë: Kam dëgjuar Pejgamberin salallahu alejhi ue selem, duke thënë: “Shejtani është dëshpëruar nga adhurimi i tij nga ana e namazlinjve në Gadishullin Arabik, mirëpo i ngacmon mes tyre”. (Muslimi).

Në këtë hynë edhe ndërsimi i bashkëshortëve mes vete dhe prishja e zemrës së tyre.

Xhabiri radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Iblisi e vëndon fronin e vet mbi ujë, pastaj i dërgon njësitët e veta, e më i afërti me të është ai që bën më shumë të keqe. Vjen njëri dhe tregon çka ka bërë, kurse i thotë s'ke bërë gjë. Pastaj vjen një tjetër dhe tregon se nuk është ndalur derisa nuk ndava një burrë nga gruaja e tij. Këtë e

afron dhe i thotë: po ti je më i miri (i keqi). A'meshi thotë: më duket se edhe e përqafton". (Muslimi).

2- Sprova e grave.

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, thotë: "Gruaja është auret (pjesë që duhet mbuluar) e kur del nga shtëpia shejtani e zbukuron". (Tirmidhiu, hadithi është sahih).

Xhabiri radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, pa një grua, andaj erdhi te gruaja e tij, Zejnebeja, e cila ishte duke fërkuar një lëkurë të rregjur. E kreu nevojën e tij me të e pastaj doli te shokët e tij dhe tha:

"Gruaja vjen e shkon në formë të shejtanit, kur ndokush prej jush shikon ndonjë grua (joshëse) le të shkojë te gruaja e vet, se kjo vepër ia largon atë që e ndien në shpirtin e vet". (Muslimi).

Imam Neveviu thotë: "Dijetarët kanë thënë se hadithi aludon në epshin dhe ftesën në sprovë, pasi që Allahu ka bërë në shpirtat e burrave që të anojnë kah gratë". (Shiko: "Komenti i Sahih-Muslimit", 9/ 178-179).

Omeri radijAllahu anhu, e mbajti një hutbe në vendin e qujatur Xhabije e tha se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka qëndruar në këtë vend të njejtë dhe ka thënë: "Silluni mirë ndaj shokëve të mi...mos të vetmohet burri me një grua, sepse i treti është shejtani". (Tirmidhiu dhe Ahmedi, hadithi është sahih).

Seid ibn Musejjebi, rahimehullah, thotë: "Kur të dëshpërohet Iblisi nga lajthitja e ndonjërit i afrohet nëpërmjet gruas".

3- Muzika.

Allahu subhanehu ve teala, thotë: "Dhe me atë alarmin e zërit tënd, mashtroje atë që mundesh prej tyre, me kalorësit e këmbësorët tu thirri (bërtitu) ata, përzieju me ta në pasuri dhe në fëmijë dhe premtoku

atyre, po shejtani nuk u premtonte tjetër, përveç mashtrim". (El-Isra: 64).

Muxhahidi duke e komentuar këtë ajet thotë: "Ajo është muzika dhe instrumentet muzikore". (shiko: "Telbisu Iblis", f. 232).

Aisheja, radijAllahu anha, thotë: Hyri te unë Pejgamberi salallahu alejhi ue selem,, kurse aty ishin të pranishme dy vasha të cilat këndonin këngë të ditës së Buathit. Ai u shtri në shtrat dhe na e ktheu fytyrën. Kur hyri Ebu Bekri radijAllahu anhu, më qortoi dhe tha: fyej të shejtanit në shtëpinë e Pejgamberit salallahu alejhi ue selem,, atëherë Pejgamberi salallahu alejhi ue selem,, u kthye e i tha: Lëri o Ebu Bekr, se çdo popull ka festat e veta, kurse kjo ditë është festa jonë...". (Buhariu).

Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, nuk e ndaloj Ebu Bekrin nga emërtimi i muzikës "fyell i shejtanit", mirëpo e lejoi në këtë ditë pasi që është festë.

Ebu Hurejre radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Zilja (këmbana) është fyell i shejtanit". (Muslimi).

4- Nxitimi, i cili të shpien në gabime dhe mëkate.

Sehl ibn Sadiu radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, thotë: "Ngadalësia është nga Allahu, kurse nxitimi nga shejtani". (Tirmidhiu, hadithi është sahih).

5- Harresa.

"Ata i ka nënshtruar djalli dhe ua ka qitur në harresë porositë e Allahut. Ata janë shoqëri e djallit, e dinë se ithtarët e djallit janë më të dëshpëruarit". (El-Muxhadele: 19).

"Kur sheh ata se janë thelluar (me tallje) në çështjet Tona, largohu prej tyre derisa të kalojnë në bisedë tjetër. Nëse djalli të bën të

harrosh (e rri me ta), pasi të bie ndërmend, mos rri me popullin mizor". (El-Enam: 68).

"Po djalli e vuri në harresë ta përkujtonte te zotëriu i tij,..." (Jusuf: 42).

6- Vesvesja dhe hedhja e dyshimeve në zemër.

Ibn Abbasi radijAllahu anhu, tregon se një njeri erdhi te Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, e i tha: O i Dërguar i Allahut ndonjërit prej nesh i vijnë disa mendime, më shumë kam dëshirë të mbeten të tilla se sa ti shpreh ato. Atëherë Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, tha: "Allahu ekber, Allahu ekber, Allahu ekber, e falënderoj Allahun, i cili kurthen e shejtanit e ka sjellë në cytje (vesvese)". (Ebu Davudi, hadithi është sahih).

Ebu Hurejre radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Ndonjërit prej jush i vjen shejtani e i thotë: kush e ka krijuar këtë? Kush e ka krijuar këtë? Derisa të thotë: Kush e ka krijuar Zotin Tënd? Nëse arrinë në këtë gradë le të kërkojë strehim te Allahu dhe le të ndalohet nga ky mendim". (Buhariu dhe Muslimi).

Abdull-llah ibn Mes'udi radijAllahu anhu, tregon se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: "Shejtani e sulmon (i afrohet) njeriun po edhe meleku e sulmon (i afrohet) njeriun. Sulmi i shejtanit është premtim për të keqe dhe përgënjeshtim të vërtetës, kurse sulmi i melekut është premtim për të mirë dhe vërtetim i të vërtetës. Ai që e gjenë këtë le ta dijë se është prej Allahut dhe le ta falënderojë Allahun për këtë, e kush gjenë tjetër gjë, le të kërkojë strehim te Allahu nga shejtani i mallkuar".

Pastaj lexoi ajetin: "Djali ju frikëson nga varfëria dhe ju urdhëron për të këqija, e

Allahu ju garanton falje (mëkatesh) e begati; Allahu është Dhurues i Madh, i Dijshëm". (El-Bekare: 268).

Ebu Tajjibi thotë se sulmi dhe afrimi janë vesveset që mbijnë në zemër nëpërmjet shejtanit". (Tuhfetul-Ahvedhi", 8/ 265).

Allahu subhanehu ve teala, thotë: "Thuaj: "Mbështetem në Zotin e njerëzve! Sunduesin e njerëzve, Të adhuruarin e njerëzve, Prej të keqes së cytësit që fshihet. I cili hedh dyshime në zemrat e njerëzve, Qoftë ai nga xhinët ose nga njerëzit". (En-Nas).

7- Gradualizimi në lajthitje dhe pasimi i politikës "hap pas hapi".

Allahu subhanehu ve teala, thotë: "O ju që besuat, mos shkoni gjurmëve të djallit, pse kush ndjek gjurmët e djallit ai urdhëron për të shëmtuara e të irituara,.." (En-Nur: 21).

Kështu ka vepruar me popullin e Nuhit alejhi selam, siç tregon Imam Buhariu nga Ibn Abbasi, radijAllahu anhum.

Siç ka ndodhur me adhuruesin nga izraelitët, të cilin e solli deri te marrëdhënia jashtëmartesore (zina), pastaj e solli në kufër, e pastaj u largua prej tij dhe e la të vetmuar. Këtë tregim e sjellin dijetarët e tefsirit gjatë komentit të ajetit: "Ata (hipokritët) janë shembull si djalli, kur i thotë njeriut: "Refuzo besimin!", e kur ai të ketë refuzuar, ai (djalli) tërhiqet prej teje; e thotë: unë i frikohem Allahut, Zotit të gjithësisë!" (El-Hashr: 16).

Allahu na mbroftë nga kurthet e shejtanit, na e mësoftë fenë e tij, na mundësoftë të veprojmë me mësimet e Pejgamberit salallahu alejhi ue selem, që të mbrohemi dhe të ngadhënjëm në këtë betejë shumë me rëndësi dhe vendimtare kundër tij.

Allahu e mëshiroftë dhe e bekoftë Pejgamberin, familjen dhe shokët e tij.

"Hadithe të zgjedhura-Perla të urtësisë nga i Dërguari i Perëndisë"
në 300 faqe, mbi 1000 hadithe, në tema të ndryshme,
me vlerësim nga dijetari Nasirudin Albani
Shtëpia botuese "Nun"-Shkup tel: +389 2 320827

Ekstremizmi

Është nevoja të flitet në këtë temë për shkak të pluhurit të ngritur rreth kësaj teme. Në këtë temë ka folur ai që ka njohuri por edhe tjetri që nuk e njeh ekstremizmin nga asnjë anë. Kur flasim gjithësisht, të gjithë themi se ekstremizmi është: prije për të bërë kërkesa e për të kryer veprime që e kalojnë çdo masë; skajshmëri, teprim. Mirëpo kur flasim për ekstremizmin në fe, shumë prej njerëzve mendojnë se çdokush që mundohet të praktikojë ligjet e Allahut dhe të bëhet mysliman i mirë, ai na qenka ekstremist dhe duhet të kemi kujdes nga ai. Ekstremizmi apo teprimi në fe padyshim se është i urrejtur, mu për atë shkak ne duhet të njihemi se çka në të vërtetë është ekstremizmi në fe.

Ekstremizëm në fe d.m.th. kalim i kufijve fetarë, ngurtësim dhe ashpërsim në të. Kjo ndodhë në atë mënyrë, që për një çështje konkrete të tejkalon ligjin e përcaktuar nga Allahu, pastaj të këmbëngulë se vetëm ai mund të jetë në të drejtë dhe të shfaqet me ashpërsi para secilit që nuk e pranon mendimin e tij. Imam Kurtubiu thotë: Ekstremizmi në fe d.m.th. kalimi i kufijve ashtu si kanë kaluar jehuditë dhe të krishterët lidhur me Isaun. Ekstremizmi i jehudive është fjala e tyre: Isau është bir lavire; ndërsa ekstremizmi i të krishterëve është fjala e tyre: Isau është zot.

Lloje nga ekstremizmi:

1. Ekstremizmi në fe, dhe atë duke besuar besime të kota, siç kanë bërë krishterët, kur thanë për Allahun: "Zoti

është i treti prej treshit", ose: "Isai është bir i Zotit", ose fjala e jehudive: "Isau është bir lavire". Në këtë lloj bën pjesë edhe ajo që bëjnë disa grupe të humbura, të cilët kanë kaluar kufijtë e përcaktuar, sikurse shiat, dervishët, havarixhët, murxhitë, etj.

2. Ekstremizmi në Kur'anin Famëlartë, dhe atë duke i kaluar kufijtë gjatë leximit të tij, me zgjatje të stërzgjatura dhe shqiptim të tepruar, si dhe, duke e komentuar me komente të pabaza.

3. Ekstremizmi në shkencë, i cili rezulton me ndërrimin e kuptimeve të Kur'anit, sikur kanë bërë disa njerëz gjatë historisë dhe disa që bëjnë në ditët e sotme. Në shikim të parë, ndonjëherë ndodhë të duket jo pajtueshmëri mes Kur'anit dhe shkencës, ashtu që ata që janë ekstremist në shkencë menjëherë nxitojnë që t'i ndërrojnë kuptimet e Kur'anit, me qëllim që mos të vijë ndesh me shkencën. E kjo pa dyshim është gabim. Është e vërtetë se shkenca e mirëfilltë nuk vjen ndesh me Kur'anin, mirëpo nëse ndonjëherë ndodhë të na duket ashtu, atëherë duhet të jemi të bindur se me siguri ka ndonjë gabim në atë përfundim shkencor apo në kuptimin tonë të Kur'anit, e assesi të bëjmë ndryshimin e kuptimit të Kur'anit.

Hyrja në fe duhet të bëhet gradualisht:

Hyrja në fe me shpejtësi dhe teprim është ekstremizëm. Ibën Munejjir ka thënë: Kemi parë ne, e po ashtu edhe njerëzit para nesh, se secili që e tepron në fe, më vonë shpëputet. Nuk kemi qëllim të ndalojmë dikë që adhurimin ta kryejë sa

më mirë, sepse ajo gjë është e lëvduar, por dëshirojmë të ndalojmë nga teprimi i cili rezulton me lodhje e plogështi. Kemi për qëllim teprimin në gjëra vullnetare që rezultojnë me braktisjen e më të lëvduarës apo lëshimin e farzit. Sikur që ka raste të atyre që falen tërë natën, e pak para sabahut i kaplon gjumi dhe flenë deri pas sabahut, ose i ikë namazi me xhemat.

Për ta kuptuar edhe më mirë këtë çështje dhe për të parë se sa është e qortuar, do t'i lexojmë disa ajete, hadithe dhe fjalë të dijetarëve në këtë temë.

Ajete rreth teprimit në fe:

1. "O ithtarët e librit, mos teproni në fenë tuaj dhe mos thoni tjetër gjë për Allahun, përveç të vërtetës. Vërtetë Mesihu, Isau, biri i Merjemes, ishte vetëm i dërguar i Allahut. Ishte fjalë e Tij që ia drejtoi Merjemes dhe ishte frymë (shpirt) nga Ai. Besoni pra Allahun dhe të dërguarin e Tij e mos thoni: "Tre". Pushoni (së thëni), se është më mirë për ju. Allahu është vetëm një Allah; I lartësuar është Ai që të ketë fëmijë. Ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë është vetëm e Tij. Mjafton Allahu si kujdestar.

2. "Thuaju: "O ithtarë të librit, mos e teproni në fenë tuaj jashtë të vërtetës dhe mos shkoni pas epsheve të një populli të mëparshëm që ka humbur, që ka shkaktuar humbjen e shumë të tjerëve dhe që u largua në tërësi prej rrugës së drejtë".

Pjesa e ajetit: "...jashtë të vërtetës..." na mëson se veprimi i asaj që është e vërtetë nuk quhet teprim në fe, nuk është ekstremizëm.

Hadithe rreth ekstremizmit:

1. Ibën Abasi rrëfen se Resulullahu, alejhi selam kishte kërkuar nga ai disa guralecë, vazhdon: I mblodha dhe kur ia

dhëna në dorë, tha: "Këso guralecë duhet, ndërsa keni kujdes nga ekstremizmi në fe, sepse të gjithë ata që u shkatërruan para jush, u shkatërruan për shkak të ekstremizmit në fe". (1)

Ja çfarë kujdesi ka pasur Resulullahu, alejhi selam që pasuesit e tij të jenë sa më larg teprimit, ndërsa sot gjatë haxhit shumë prej myslimanëve marrin gurë mjaft të mëdhenj për të gjuajtur "shejtanin". Këtu mësojmë se prej shkaqeve kryesore të ekstremizmit në fe qenka padija e njerëzve për fenë.

2. Ma'kil ibën Jesari radijallahu anhu, rrëfen se Resulullahu, alejhi selam ka thënë: "Dy lloj të njerëzve nuk do ta arrijnë shefatin tim: udhëheqësi zullumqar e tiran dhe ai që e tepron në fe, dëshmon kundër tjerëve dhe largohet nga ata". (2) Ekstremisti, lëre që vetë është në gabim, por edhe i qorton të gjithë ata nuk përmbajnë mendimin e tij. Për këtë shkak, nuk do ta ketë fatin e ndërmjetësimit të Resulullahut, salallahu alejhi ue selem.

3. Uehb ibën Abdullah rrëfen se Resulullahu, alejhi selam e kishte vëllazëruar Selmanin me Ebu Derdanë. E vizitoi njëherë Selmani Ebu Derdanë dhe e pa Umu Derdanë (bashkëshorten e Ebu Derdasë) jo të veshur si duhet, dhe i tha: Ç'është puna me ty? Tha: Vëllai yt, Ebu Derdaja nuk ka nevojë për dynja. Pastaj erdhi Ebu Derdaja dhe i shtroi të hajë, e Selmani i tha: Ha edhe ti! Tha: Jo, se agjëroj. As unë nuk do të ha përderisa ti nuk han – ia ktheu Selmani, ashtu që ngrënë të dytë. Gjatë natës, Ebu Derda deshi të ngrihet për tu falur, por Selmani i tha: Fli dhe ai fjeti, më vonë deshi të ngrihet prapë, por Selmani sërish e ndaloi. E kur mbeti pjesa e fundit e natës, u ngrit Selmani dhe tha: Ngrihu tani, dhe u falën

bashkë. Pastaj Selmani i tha: Ndaj Zotit tënd ke borxh, ndaj vetes tënde ke borxh dhe ndaj familjes tënde ke borxh. Ndaj secilit duhet ta pastrosh borxhin. Pas kësaj Ebu Derda shkoi te Resulullahu, alejhi selam dhe ia tregoi rastin, e Resulullahu, alejhi selam tha: "Selmani e ka thënë të vërtetën". (3)

4. Ajsheja rrëfen se Umu Habibe dhe Umu Seleme në Abesini kishin parë një kishë që brenda kishte piktura dhe këtë ia treguan Resulullahut, alejhi selam i cili tha: "Tek ata, kur ishte ndonjë njeri i mirë e pastaj vdiste, mbi varrin e tij ndërtonin fatore dhe në atë fatore pikturonin ato piktura. Ata janë njerëzit më të këqij tek Allahu në ditën e Kijametit". (4) Sepse, e tepruan në nderimin e atyre njerëzve, derisa i kaluan kufijtë.

5. Ebu Tha'lebe el-Hushenij rrëfen se Resulullahu, alejhi selam ka thënë: "Allahu ka caktuar farze, mos i nëpërkëmbni ato, ka caktuar kufij e mos i kaloni ato, ka ndaluar disa gjëra e mos iu afroni atyre, ndërsa do gjëra i ka lënë jo nga harresa, e mos hulumtoni pas tyre". (5)

6. Ajsheja radijallahu anha, rrëfen se njëherë kishte hyrë Resulullahu, alejhi selam dhe një grua ishte mysafir te ajo, e ai pyeti: Kush është? Tha: Filaneja, dhe filloi ta lëndojë se sa falet. Resulullahu, alejhi selam tha: Hë, veproni atë që mundeni, se pasha Allahun, Ai nuk lodhet përderisa ju të lodheni. Feja më e dashur tek Allahu është ajo që është e vazhdueshme. (6) Allahu, subhanehu ue teala, dëshiron që robërit e Tij të punojnë vazhdimisht edhe nëse është pak. Allahu nuk lodhet asnjëherë duke të shpërblyer për punën që e bën, andaj vepro atë që mundesh, që vazhdimisht të shpërblehesh.

Assesi mos vepro atë që nuk mundesh, sepse pa dyshim se do të lodhesh, e kur të lodhesh ti, atëherë edhe Allahu "lodhet" – e ndërpret shpërblimin e Tij për ty. Kështu e kanë shpjeguar dijetarët këtë hadith, e jo se me të vërtetë Allahu subhanehu ue teala, lodhet.

7. Enesi radijallahu anhu, rrëfen se Resulullahu, alejhi selam kishte parë një njeri i cili ndihmohej nga djemtë e tij për të ecur, dhe pyeti: Ç'është puna e tij? Thanë: Është zotuar se do të ecë. Resulullahu, alejhi selam tha: Allahu aspak nuk ka nevojë që ky person ta dënojë veten, dhe e urdhëroi që të hipë në kafshë.

8. Enesi, radijallahu anhu, po ashtu rrëfen se disa as'habë kishin pyetur ndonjëherë prej grave të Resulullahut, alejhi selam rreth adhurimit të tij në jetën private. E pas kësaj, njëri nga ata tha: Unë nuk do të martohem; tjetri: Unë nuk do të ha mish; e tjetri: Unë nuk do të fle në shtrat. Kur mori vesh Resulullahu, alejhi selam për këtë, pasi falënderoi dhe lëndoi Allahun, tha: Ç'është puna me disa njerëz që kanë thënë kështu e ashtu. Dijeni se unë falem dhe fle, agjëroj dhe ha dhe martohem po ashtu. Kush largohet nga suneti im, ai nuk është nga unë". (7)

9. Transmetohet se Abdullah ibën Mugaffel kishte dëgjuar të birin duke u lutur: O Zot, kërkoj një pallat të bardhë në të djathtën e xhenetit kur të hyj; dhe i tha: O bir, kërko xhenetin dhe mbrojtjen nga xhehenemi, se unë e kam dëgjuar Resulullahun, alejhi selam duke thënë: "Në këtë popull do të ketë njerëz që do t'i kalojnë kufijtë në abdes dhe lutje". (8) Teprimi në lutje pra, qenka duke hyrë në detaje gjatë lutjes, sikur ky rast me djalin e Abdullahit, ndërsa në abdes kjo ndodhë duke i larë pjesët e abdesit më shumë se

tri herë, duke dyshuar a ka depërtuar uji mirë apo jo etj.

10. Xhabir ibën Abdullahu rrëfen se Resulullahu, alejhi selam ka thënë: "Ky din është i fortë, hyn në të me ngadalësi e mos ia bën të urrejtshme vetes tënde adhurimin...". (9) Feja është më e fortë dhe më e madhe se ti, mos mendo se mund ta praktikosh atë për një apo dy ditë, andaj fillo praktikimin e tij dalë nga dalë, se përndryshe do të mërzhitesh pas një kohe dhe nuk do ta dëshirosh adhurimin.

11. Enesi rrëfen se si njëherë Resulullahu, alejhi selam duke hyrë pa një litar mes dy shtyllave dhe pyeti: Pse është ky litar këtu? Thanë: Është litari i Zejnebes, e cila kur lodhet në namaz mbahet në të. Resulullahu, alejhi selam tha: Hiqeni, faluni sa të mundeni, e kur të lodheni uluni". (10)

12. Ajsheja radijallahu anha, rrëfen se si njëherë Resulullahu, alejhi selam veproi diç por me lehtësim, e disa nuk vepruan ashtu. Mori vesh Resulullahu, alejhi selam për këtë, dhe pasi e falënderoi dhe lëvdoi Allahun tha: Ç'është puna me disa njerëz të cilët kanë drojën të veprojnë si veprojnë unë? Vallahi, dijeni se unë më së miri e njoh Allahun dhe jam më i devotshëm se të gjithë". (11) Andaj, nëse për një çështje ka lehtësim të argumentuar, veproje më të lehtë sepse kështu ka vepruar Resulullahu, alejhi selam por edhe shpërblimi është më i madh.

13. Omeri radijallahu anhu, thotë: Kam dëgjuar Resulullahun, alejhi selam duke thënë: Mos më ngrini sikur krishterët që e ngritën birin e Merjemes, unë jam rob. Thuani: rob i Allahut dhe i dërguar i tij.

14. Resulullahu, alejhi selam kur e dërgoi Ebu Musën dhe Muadhin në Jemen, u tha: "Lehtësoni e mos vështirësoni, përgëzoni e mos i largoni njerëzit dhe

ndihmohuni mes vete". Ebu Musa pyeti: O i dërguar i Allahut, ne do të jemi në një vend të cilët nga mjalti prodhojnë një lloj pije, dhe një lloj tjetër nga elbi. Resulullahu, alejhi selam tha: Çdo gjë që deh është e ndaluar". (12)

Nga fjalët e dijetarëve kemi zgjedhur këto fjalë të Alijut, radijallahu anhu: "Lidhur me mua do të shkatërrohen dy lloj njerëz: njëri që më do me ekstremizëm për gjëra që unë nuk i posedoj, dhe tjetri i cili më urren dhe bën shpifje për mua". Po ashtu e ka porositur familjen e tij: "Mos e teproni në qefinin tim".

Disa dëme të ekstremizmit:

1. Largon nga Allahu dhe patjetëron Zjarrin.

2. Ndërpret punën dhe pamundëson vazhdimësinë në të.

3. Është argument i mendjes së dobët dhe është derë për shejtanin.

4. Është argument i padijes dhe i kuptimit të cekët.

5. Shkakton vesveset.

6. Shtrëngon shpirtin dhe shkakton pikëllimin.

Omer Berisha

Referencat: 1). Nesaiu 2). Ibën Ebu Asimi në "sunne". Albani thotë se është sahih. 3). Buhariu (1968) 4). Buhariu (427) dhe Muslimi (528) 5). Hakimi në mustedrek, ku ka thënë se hadithi është sahih dhe në këtë e ka pëlqyer Dhehebiu. Po ashtu Bezari thotë se zinxhiri i këtij hadithi është sahih. 6). Buhariu (43) Muslimi (785) 7). Buhariu (5063) Muslimi (1401) 8). Sahih Ebu Davud (1/21) 9). Bejhekiu në Sunen Kubra, Albani thotë se është sahih në Sahihul Xhamië (2242) 10).

Zmadhimi i mëkatit në Ramazan

Meseleja e parë: Vlera e Ramazanit

Për vlerën e Ramazanit flasin shumë argumente të shariatit. Prej tyre është edhe hadithi të cilin e transmeton Buhariu, ku Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Allahu ka thënë: çdo vepër e njeriut është për të përveç agjërimit, ai është për Mua dhe Unë e shpërblej atë. Agjërimi është mburojë, andaj nëse dikush është agjërueshëm mos të flet fjalë të ndyta dhe mos të bërtet. Nëse e shan dikush le të thotë: unë agjëroj, unë agjëroj. Pasha Atë që në Dorë të Tij është shpirti i Muhamedit era e gojës së agjëruesit është më e këndshme se sa aroma e miskut. Agjëruesi i ka dy gëzime: një kur ha iftarin dhe e dyta kur të takohet me Zotin e vet".

Në këtë hadith i kemi katër myzhde:

Një: Agjërimi është për Allahun dhe Ai veçanërisht shpërblen për te.

Pa dyshim se Allahu është Ai që shpërblen për të gjitha adhurimet, mirëpo veçimi i agjërimit këtu tregon shtimin e shpërblimit që e jep Allahu për këtë vepër.

Sufjan ibn Ujejne ka thënë: "Në Ditën e Kijametit Allahu do ta llogarit robin e Tij. Do t'ia lajë të gjitha zullumet që ua ka bërë njerëzve me veprat e tija, e do t'i mbetet vetëm agjërimi. Zullumet tjera do t'i merr përsipër Allahu t'ia lajë, kurse me agjërimitin ka me hy në xhenet".

Disa dijetarë tjerë kanë thënë: secila vepër shpërblimin e ka të kufizuar, kurse agjërimi e ka pa kufi. Argument për këtë është hadithi në sahihun e Muslimit: "Çdo vepër e njeriut shumëfishohet. Një e mirë në dhjetëfish deri në shtatëqind fish. Allahu,

subhanehu ve teala, ka thënë: përveç agjërimit, sepse ai është për Mua dhe unë shpërblej për te".

Dy: Agjërimi është mburojë, domethënë mburojë nga zjarri i xhehenemit.

Transmeton Tirmidhi se Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Agjërimi është mburojë nga Zjarri".

Pasi që shejtani qarkullon në njeriun në kapilarët ku i qarkullon gjaku, e kur agjëron njeriu i ngushtohen kapilarët për shkak të qarkullimit të vogël të gjakut, e me këtë ia ngushtojmë kanalet shejtanit, andaj pakësohen vesveset. Nga ana tjetër në këtë muaj edhe prangosen djajt, andaj njerëzit jepen pas adhurimeve, e agjërimi bëhet mburojë.

Tre: Era e keqe e agjëruesit është më e këndshme se aroma e miskut.

Kjo pa dyshim se është nderim (keramet) për agjëruesin.

Dijtarët kanë thënë: Allahu e shpërblen me aromë të mirë në ahiret, mu ashtu sikurse ndodhë edhe me njeriun që plagoset në rrugë të Zotit. (shih: "Feth'hul-Bari", 4/106).

Katër: agjëruesi gëzohet me agjërimitin e vet dhe takimin me Allahun.

Domethënë kur e takon dhe e shpërblen, kjo pa dyshim e gëzon.

Vlerat e agjërimit

Prej vlerave të agjërimit është:

1- Falja e mëkateve.

Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Kush e gjallëron natën e kadrit me besim dhe shpresë, i falen të gjitha mëkatet e bëra dhe kush e agjëron

Ramazanin me besim dhe shpresë i falen të gjitha mëkatet e bëra". (Buahriu dhe Muslimi)

Domethënë duke i besuar urdhrave të Allahut, me nijet të sinqertë dhe duke shpresuar shpërblimin e Allahut.

Gjithashtu Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Natën e parë të muajit Ramazan prangosen shejtanët dhe xhinët e inatosur, mbyllen dyert e xhehenemit, dhe nuk hapet asnjë derë, hapen dyert e xhenetit dhe nuk mbyllet asnjë derë. Thërret një thirrës: o kërkues i së mirës urdhëro, kurse ti o kërkues i të keqes ngurro. Allahu në çdo natë ka njerëz që i liron nga zjarri i xhehenemit". (Tirmidhiu, hasen).

Prej vlerave të Ramazanit është edhe prania e natës së Kadrit në këtë muaj, i cili është më i mirë se një mijë muaj, domethënë më i mirë se 83 vjet.

Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Ju ka ardhur muaji, në të cilën ka një natë, e cila është më e mirë se një mijë muaj, ai që privohet nga e mira e saj është i privuar nga të gjitha të mirat, sepse vetëm i privuari privohet nga të mirat e saja". (Hasen, Ibn Maxhe).

Meseleja e dytë: Shkaku i zmadhimit të mëkateve në Ramazan

Mëkatet në këtë muaj shumëfishohen dhe zmadhohen.

Cili është shkaku?

Shkaku është zgjedhja dhe dallimi i cili e shumëfishon dhe zmadhon shpërblimin po edhe dënimin, pa marrë parasysh se kjo zgjedhje ka të bëjë me vendin, kohën ose personin.

a) Allahu e ka zgjedhur Pejgamberin, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, edhe kjo zgjedhje ka qenë shkaku për shumëfishim të shpërblimeve të tij, fiton shpërblimin e

atyre që veprojnë sipas udhëzimeve të tij, duke mos iu pakësuar atyre aspak shpërblimi, e me këtë është bërë njeriu me grada më të larta.

Gjithashtu Allahu, subhanehu ve teala, e ka lajmëruar se edhe gabimet e tij i shumëfishohen, edhe pse ai nuk gabon, mirëpo për sqarim fetar ndaj atyre që janë të zgjedhur dhe të dalluar.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Në të vërtetë ata (idhujtarët) gati arritën të sprovonin ty nga ajo që Ne ta shpallëm, e të trillosh tjetër nga çka të shpallëm, e atëherë do të zinin ty mik. Dhe sikur Ne të mos të kishim forcuar ty, ti gati anove diçka pak te ta. E atëherë Ne do ta shijonim mundimin dyfish të kësaj jete dhe dyfish të jetës tjetër, e pastaj ti nuk do të gjeje mbrojtës kundër nesh". (El-Isra: 73- 75).

Domethënë dënim dyfish në dynja dhe dyfish në ahiret.

Në këtë drejtim është edhe dedikimi që u është bërë nënave të besimtarëve, grave të Pejgamberit, sal-Allahu alejhi ve sel-lem: "O gra të Pejgamberit, cilado prej jush që bën punë të ligë e të shëmtuar, asaj dënimi i shtohet dyfish, e kjo për Allahun është shumë lehtë. E kush prej jush i përvishet adhurimit të Allahut dhe respektimit të të dërguarit të Tij dhe bën punë të mira, asaj do t'i japim shpërblimin e dyfishtë dhe për të kemi përgatitur furnizim të këndshëm". (El-Ahzab: 30- 31).

Pra, ato ia ka zgjedhur Allahu, subhanehu ve teala, Pejgamberit, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, andaj kanë hise në dhunti, në besim, grada dhe jetesë në shtëpinë e Pejgamberit, në të cilat nuk kanë tjerat, andaj atyre nuk u ka hije mëkati, ashtu sikurse u shumëfishohet shpërblimi i veprave të tyre të mira.

b) I njëjti vendim vlen edhe për vendet e

veçuara dhe të dalluara, siç është Meka, për shembull. Veprat që bëhen në Mekë janë më të mëdha se ato që bëhen jashtë Mekës. Namazi që falet në Mesxhidul-Haram është sa njëqind mijë namaze që falen në xhamitë tjera, po edhe me mëkatim është e njëjta gjë.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "S'ka dyshim se ata të cilët nuk besuan dhe pengojnë prej rrugës së Allahut dhe prej xhamisë së shenjtë (Qabes), të cilën Ne e bëmë të barabartë për njerëz, qofshin vendas ose të ardhur, dhe kushdo që të përpiqet të bëjë ndonjë të keqe a ndonjë mëkat, Ne kemi për t'ua shijuar një dënim të idhët". (El-Haxhxh: 25).

c) Kjo dispozitë vlen edhe për kohërat e veçuara dhe të dalluara, siç është muaji i Ramazanit, kurse argument i veçimit janë argumentet që tregojnë madhështinë e këtij muaji, sasia e madhe e shpërblimit, mëshira e Allahut në këtë muaj, hapja e dyerve të xhenetit, mbyllja e dyerve të xhehenemit, prangosja e djajve, veçimi me natën e Kadrit. Pra, shpërblimet qenkan të shumëfishuara. Nëse e kuptojmë se shpërblimet janë të shumëfishuara, atëherë vërtetohet se edhe dënimet shumëfishohen, pasi që treguam më herët se në raste të veçimit dhe dallimit shumëfishohen edhe shpërblimet edhe dënimet.

Pastaj kemi edhe argument konkret që tregon se mëkati në Ramazan është shumë i madh, pasi që Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, i ka parë disa njerëz (në ëndërr) të varur për kapilarët e tyre, barkarë dhe duke rrjedhur gjaku prej tyre, dhe ka pyetur: kush janë këta? Melekët janë përgjigjur: ata janë që kanë ngrënë para se ta përfundojnë agjërimin e tyre". (Ibën Huzejme, shih: "Sahihu tergibi

ve terhibi", 1/420).

Kurse Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, njeriun që ka patë marrëdhënie intime me gruan e tij gjatë ditës së Ramazanit i ka përcaktuar kefaretin më të rëndë, kefaretin e vrasjes dhe dhiharit: lirim të një robi, e nëse nuk gjen, atëherë agjërim të dy muajve radhazi, e nëse nuk mundet, atëherë, të ushqejë gjashtëdhjetë të ngratë.

Kefareti i madh vjen si rezultat i mëkatit të madh.

Kurse në këtë rast njeriu që ka bërë marrëdhënie me gruan e tij, të cilën e ka hallall, paska bërë gabim shumë të madh që duhet shpëguar me këtë kefarete kaq të madh, kjo tregon se mëkati që bëhet në Ramazan nuk është sikur mëkati që bëhet jashtë Ramazanit.

Pastaj nëse ky mëkat qenka nëse njeriu nuk e respekton ndershmërinë e këtij muajit duke bërë marrëdhënie me gruan e vet, e çka të themi për ata që bëjnë zina?!

Meseleja e tretë: Definicioni i mëkatit.

Ka njerëz që aspak nuk i përfillin rregullat e sheriatit, andaj mëkatet i renditin në rangun e gjërave të lejuara, andaj duhet sqaruar se çka është mëkat sipas sheriatit.

Në arabisht fjala mëkat vjen në disa forma, kurse të gjitha e kanë një kuptim fetar, vjen si (, () , () , () , ()).

Të gjitha këto shprehje e shprehin realitetin e asaj që e bën njeriu kur i kundërshton urdhrat e Allahut dhe të gjitha këto shprehje kanë ardhur në kontekstin e qortimit dhe kërcënimit.

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Edhe ata të cilët kur bëjnë ndonjë (mëkat) të shëmtuar ose i bëjnë zullum vetvetes, e

përmendin Allahun dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre - e kush i falë mëkatet përveç Allahut? - dhe që duke ditur, nuk vazhdojnë në atë që kanë punuar (në të keqen)". (Ali Imran: 135).

"Kush e kundërshton Allahun dhe të dërguarin e Tij, dhe i shkel dispozitat e Tij, atë e shtie në Zjarr të përjetshëm. E për të është një dënim i rëndë". (En-Nisa: 14).

"Kush bën ndonjë gabim ose mëkat, e pastaj atë ia hedh një të pafajshmit, ai ngarkohet me një shpifje e me një mëkat të hapët". (En-Nisa: 112).

"Po, (do të ju kapë Zjarri) ai që bën keq dhe që e vërshton gabimet e tij, ata janë banues të zjarrit, aty janë përgjithmonë". (El-Bekare: 81).

"Pendim i pranueshëm te Allahu është vetëm ai i atyre që e bëjnë të keqen me mosdije shpejt pendohen; të tillëve Allahu ju pranon pendimin, se Allahu është më i dijshti, më i urti". (En-Nisa: 17).

Të gjitha këto forma ku përmendet mëkati e kanë një kuptim: kundërshtim i urdhrave të Allahut, me moszbatim ose me veprim.

Kundërshtimi bëhet duke lënë ndonjë vaxhib, obligim ose duke bërë ndonjë haram, ndalesë, këtu nuk hyn lënia e ndonjë mendubi, ose veprimi i ndonjë mekruhi, sepse mendub është çdo vepër për të cilën shpërblehet ai që e bën, mirëpo nuk denohet nëse nuk e bën, kurse mekruhi është çdo vepër për të cilën nuk denohet nëse e bën dhe shpërblehet nëse e le. Andaj në këto dy kategori nuk hyn mëkati.

Kurse nëse lë një obligim, ke bërë mëkat dhe nëse ke bërë një gjë të ndaluar, ke

bërë mëkat.

Andaj kur thuhet filani ka bërë mëkat, nënkuptohet se filani ka lënë ndonjë obligim ose ka bërë ndonjë ndalesë.

I tërë ummeti janë të pajtuar se myslimanët duhet t'i kryejnë obligimet dhe të largohen nga haramet.

Çdo gjë që ka urdhëruar Allahu është obligim, siç është namazi, agjërimi, haxhi, zeqati, bamirësia ndaj prindërve, vërtetësia, amaneti, mbulesa për gruan, pëmbushja e premtimit, ruajtja e gjuhës, etj, kurse çdo gjë që ka ndaluar Allahu është haram, siç është shirku, sihri, falli, kamata, zinaja, ryshfeti, ngrënia e pasurisë së huaj, lakuriqësia e grave, mosrespektimi i prindërve, gënjeshtra, përgojimi, bartja e fjalëve, etj.

Obligimet janë të njohura edhe haramet janë të njohura, siç ka thënë Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem: "Hallalli është i qartë dhe harami është i qartë".

Andaj s'ka hapësirë për të ndryshuar gjërat, sepse Allahu ka garantuar ruajtjen e fesë, Kur'anin dhe sheriatin, kur ka thënë: "Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij". (El-Hixhr: 9).

Së fundi dije se mëkat është ajo që ti e ndien se është mëkat, siç ka thënë Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem: "Mëkat është ajo që të ngacmon në gjoks, dhe nuk ke dëshirë ta shohin njerëzit tjerë".

Natyra e pastër dhe zemra e shëndoshë e orientojnë njeriun drejt të vërtetës, sepse hallalli është i qartë, po ashtu edhe harami është i qartë, e vërteta shndrit, kurse e kota është e zbehtë.

Dr. Lutfullah Abdul-Adhim Hoxha
Përshtati: Bekir Halimi

Gruaja dhe familja

Këshillë bashkëshortëve

Këshillën time e filloj duke treguar rreth Luftës së Dytë Botërore, Armatës britaneze dhe shkretëtirës egjiptase! Njëerës nga betejat më vendimtare, që ndodhi më 1942 gjatë Luftës së Dytë Botërore, e quajtur beteja El-Alemejn, e quajtur ashtu sipas vendit në Egjiptin verior. Është e mirënjohur që gjermanët okupuan Afrikën Veriore dhe arritën deri në Egjipt. Shpresonin ta pushtojnë Kanalin e Suezit, mandej të pushtojnë fushat e naftës në Iran dhe Irak, mandej ta sulojnë Bashkimin Sovjetik nga jugu, etj.

Britanezët qenë të qëndrueshëm që asnjëherë të mos e lejojnë të ndodh ajo, ndaj sollën ushtarakun më të mirë, gjeneralin Berndard Montgomerin që të udhëheq ushtrinë e tyre me qëllim të ndalimit të gjermanëve dhe përparimit të tyre. Ndodhi një betejë e vërtetë. Ëndrrat gjermane nuk u realizuan, britanezët marrin fitoren ndërsa shumë luftëtar vdiqën dhe u varrosën në shkretëtirën El Alemejn.

Ajo që neve na intereson, nuk është ndodhia mes britanezëve dhe gjermanëve. Ne na intereson që pas luftës, shumë familjarë të ushtarëve të rënë në El Alemejn, erdhën të vizitonin varret e tyre. Disa nga ata, lanë ca fjalë të gdhendura në varret e tyre. Ndër ta, gjenden fjalët e një vejushe të re angleze e cila i shkroi burrit të saj: "Për Botën, ti qe vetëm ushtar, por për mua, ti ishe Bota e tërë!"

Ndaj, gjatë martesës, ju nuk fitoni vetëm bashkëshorte, ju fitoni gjithë botën. Nga tani e në botën e ardhshme,

bashkëshortja jote do të jetë partneri yt në jetë, bashkëudhëtar dhe shoku më i mirë. Do t'i ndajë me ty çastet, ditët dhe vitet. Do ta ndajë me ty gëzimin dhe dëshpërimin, sukseset dhe dështimet, ëndrrat dhe frikësimet tua. Kur do të jesh i dobët, ajo më së miri do të kujdeset për ty; kur të kesh nevojë për ndihmë, do të bëjë gjithë ç'ka mundet; kur të kesh ndonjë sekret, ajo do ta ruajë më së miri; kur të kesh nevojë për këshillë, ajo do ta jep. Ajo gjithnjë do të jetë me ty. Kur të zgjohesh në mëngjes, gjëja e parë që shohin sytë tua është ajo.

Gjatë ditës, ajo do të jetë me ty, në qoftë se në një moment nuk është me ty, fizikisht, ajo do të mendojë për ty me gjithë zemër, mendime e shpirt. Kur të shkoni të flini, ajo do të jetë gjëja e fundit që e sheh; madje edhe kur flenë ti, sërish do ta shohësh atë në ëndërr. Shkurtë, ajo do të jetë e gjithë bota për të dhe ti do të jesh e gjithë bota për të.

Përshkrim më i mirë të cilin personalisht e kam lexuar ndonjëherë e që përshkruan afërsinë e bashkëshortëve për njëri-tjetrin, paraqet ajeti Kur'anor: 'Ju jeni veshja e tyre dhe ato janë veshja e juaj.'

Bashkëshortët janë sikur petku për njëri-tjetrin, ngaqë ia sigurojnë njëri-tjetrit mbrojtjen, konfortetin, mbulesën, ndihmën dhe pasurinë. Paramendoni sikur të udhëtonit në Alaskë pa veshje! Bashkëshortët tanë na sigurojnë në të njëjtën mënyrë mbrojtjen dhe konfortetin, mbulesën dhe ndihmën, në udhëtimet

tona në këtë botë sikur veshja që do të na nevojitej në udhëtimin tonë në Alaskë.

Relacioni mes bashkëshortëve është gjëja më e shenjtë nga të gjitha relacionet: vlera e dashurisë dhe kujdesit, intimitetit dhe afërsisë, mëshirës dhe mirëkuptimit dhe qetësisë e cila mbushë zemrën e bashkëshortëve. Kjo paraqet vepër Hyjnore. Vetëm Zoti me fuqinë e pakufizuar, mëshirën e pafund dhe Urtësinë e shkëlqyer, mund të forcojë këto ndjenja të shkëlqyera në zemrat e bashkëshortëve.

Faktikisht, Allahu na kujton ata që shkojnë shenjave të Tij në Univers, janë ndjenjat në zemrat e bashkëshortëve ndër shenjat e Tij që duhet udhëzuar qeniet njerëzore kah Ekzistenca e Tij.

Sic qëndron në Kur'an, (Er-Rum 21): "Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje te ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë."

Mirëpo zemra e njeriut nuk është qenie e palëvizshme, ajo është mjaft dinamike. Dashuria mund të thahet dhe zbehet. Lidhja bashkëshortore mund të dobësohet nëse për të nuk kemi kujdes. Lumturia në bashkëshortësi nuk vjen vetvetiu. Fati konstant kërkon dhënie dhe sakrificë konstante nga të dy anët. Që pema e dashurisë bashkëshortore të mbijetojë, të mbetet e gjallë dhe ta vazhdojë rritjen, toka duhet të jetë e palodhshme, e mirëmbajtur dhe e kujdesur. Ndaj, ja këtu disa këshilla si ta mirëmbajmë këtë pemë, që vazhdimisht të rritet:

Në botën tonë, jetojmë një jetë dinamike, të rrethuar me tabela të

dendura dhe të stërbushur me afate. Për bashkëshortët, kjo domethënë, ndoshta më nuk do të gjeni kohë që të kaloni së bashku, të vetmuar dhe larg nga obligimet. Këtë nuk duhet ta lejoni asnjëherë të ndodh! Mundohuni që periodikisht të gjeni kohë, të kryeni ndonjë punë, larg nga bota tjetër. Kujtoni se Pejgamberi alejhi selam gjente kohë që të shkojë i vetëm me bashkëshorten Aishen radijallahu anha, në shkretëtirë, për të garuar. Fillimisht ajo ia kalonte, mirëpo pasi fitoi pak në peshë, filloi ai t'ia kalojë...

Dil rregullisht jashtë me të dhe bëni çfarëdo lloj aktiviteti. Shkoni në bregdet. Vizitoni familjen dhe shokët.

Shkoni në xhami, në piknik etj. Kujtoni se Resulullahu, alejhi selam ndante kohë që të shkojë me gruan e tij të shohë lojërat e etiopianeve të reja.

Gjithmonë të kesh romansë në jetë. Jeta moderne gati e transformoi qeniet njerëzore në robot apo high-tech - maqina pa emocione.

Shfaqja e emocioneve është e nevojshme që ta ruajmë lidhjen bashkëshortore, larg nga dryshku dhe dezintegrimi. Mbaje mend, do të shpërblehesh nga Allahu për çdo emocion që tregon ndaj gruas tënde. Ashtu siç thotë Resulullahu, salallahu alejhi ue selem: "Do të shpërbleheni për gjithë ku kërkonti kënaqësinë e Allahut, madje edhe për ushqimin që vëni në gojë të bashkëshortes." Asnjëherë mos e nënçmo vlerën për gjëra që duken të vogla, ashtu siç është vënia e ushqimit në gojë të gruas, hapja derën e veturës etj. Kujtoni se Resulullahu, alejhi selam vënte gjurin e tij që bashkëshortja të shalonte

devenë... Mundohu që gjithnjë të gjesh kohë për lutje të përbashkët.

Forcimi i lidhjes mes teje dhe Allahut është garantim më i mirë që lidhja jote bashkëshortore, të mbetet gjithnjë e fortë. Kjo do të rezultojë me pasje të qetësisë më të madhe në shtëpinë tënde. Kujto si Pejgamberi, alejhi selam gjithnjë tregonte lutje dhe dëshira për bashkëshortët e ri, të cilët zgjoheshin natën të falen, ai madje udhëzonte që nëse njëri prej tyre ngrihet, le ta thirr tjetrin që nuk është ngritur, madje edhe me stërpikje me ujë në fytyrën e tij/saj.

Mundohu që gjithnjë me vepra a me fjalë të jesh i mirë ndaj bashkëshortes. Bisedo me të, buzëqeshu, kërko këshillën e saj, pyete për mendimin e saj, harxho kohë të vyeshme me të dhe kujto se Pejgamberi alejhi selam ka thënë: "Më të mirët nga ju janë ata që janë më të mirë ndaj bashkëshorteve..."

Në fund, nuk mjafton vetëm ta dashurosh bashkëshorten. Gjithashtu duhet të duash atë që ajo do. Familjen e saj, dashamirët e saj duhet të jenë edhe

dashamirë për ty. Mos u bë si kolegu im, i cili nuk kënaqej që, prindërit e bashkëshortes së tij, të vijnë në vizitë, për disa javë. Ai sinqerisht asaj i thotë: 'Nuk i dua prindërit tu'. Natyrisht se e shikoi me hidhërim dhe ia ktheu: 'Edhe unë nuk i dua prindërit tu'.

Gjithashtu, nuk mjafton ta duash deri sa vdekja t'ju ndajë. Dashuria nuk duhet të ndërpritet dhe ne besojmë që, ekziston bota tjetër pas kësaj. Atje ku ata të cilët bëjnë gjëra të drejta në këtë botë, do të bashkohen me bashkëshortet dhe pasardhësit e tyre. Shembull më i mirë është Pejgamberi alejhi selam dashuria e të cilit ndaj Hatixhes radijallahu anha, vazhdoi edhe pas vdekjes së saj. Edhe shumë vite pas vdekjes së saj, ai asnjëherë nuk harroi që kur të therë ndonjë dele, një pjesë t'ia dërgonte shoqeve të saj...

Duaje bashkëshorten tënde dhe atë që ajo do, dhe atë, jo deri në vdekje, por deri sa të bashkoheni përsëri në botën tjetër.

Inshaallah!

Sherif Muhammed
Përktheu: Ebu Jasin
Redaktoi: O. B.

Gruaja e duhanxhiut

Jam martuar para dhjetë vjetësh me një djalosh duhanxhi, Por atëherë unë nuk e dija se ai pinte duhan. Pasi që ishte i kulturuar, i matur dhe me sjellje të mirë, ishte edhe i rregullt në namaz, kjo gjë më shtyri ta dua edhe më tepër. Mirëpo nga shkaku i duhanit edhe erës së keqe të tij që ndjehej edhe në rrobat e tij unë fillova ta ndjej veten shumë keq. U mundova disa herë ta bindë që ta lë duhanin e ai

më premtonte se do ta bënte këtë, mirëpo këtë punë ai e zvarriste dhe e linte për më vonë. Kjo situatë zgjati një kohë, gjersa unë fillova ta urrej vetveten.. Ai thithte duhan në shtëpi, në veturë dhe në çdo vend, saqë më shkoi ndërmend të kërkoj shkurorëzim nga shkaku i duhanit... Pas disa muajve Allahu na dhuroi fëmijë dhe kjo gjë më pengonte të kërkoja talak. Foshnja jonë u sëmurë nga astma

bronhiale, kurse mjeku më tha se kjo sëmundje i është paraqitur nga shkaku i duhanit që pihet përreth. Normalisht, se prindi i foshnjes pinte duhan afër tij. Megjithëkëtë përsëri burri im nuk e la duhanin. Një natë ma nxori gjumin kollitja e rëndë e foshnjes e unë fillova të qaj për të dhe për mua... Vendosa ta përfundoj këtë fatkeqësi, le të më kushtojë sa të më kushtojë, mirëpo diç nga brenda më thoshte... pse nuk i drejtohesh Allahut me lutje?! U ngrita, mora abdes dhe fala namaz. lu luta Allahut që të më ndihmojë në këtë fatkeqësi dhe ta udhëzojë burrin tim që ta lë duhanin e vendosa që të pres një kohë... Një mbrëmje shkua për vizitë te një i sëmurë i familjes, i cili ishte i shtrirë në një spital të Rijadit. Kur dolëm nga spitali deri sa po shkonim te vetura, burri im e ndezi sërish një cigare. Afër veturës sonë pamë një mjek i cili po kërkonte veturën e tij në parking. Në befasi u drejtua nga burri im dhe i tha: Vëllai im! Që nga ora shtatë në mëngjes, unë dhe ekipi im, jemi duke u munduar që të shpëtojmë një viktimë të kësaj cigare të mallkuar, nga sëmundja e kancerit në mushkëri! Eshhtë djalosh në moshën tënde, i martuar dhe me fëmijë! A dëshiron të vish me mua dhe të shohish se sa vuan ky i sëmurë?! Të shohësh gjendjen e fëmijëve të tij të vegjël dhe gruas së tij të re përreth tij! T'i shohësh lotët që dalin prej syve të tyre duke pyetur për gjendjen e babait të tyre. Oh sikur të jetë e mundshme të ndiesh atë që ndien ai, i cili është në përkujdes intenziv, kur i sheh fëmijët duke qajtur dhe kur të shohësh se si i rrjedhin lotët mbi qeset e oksigjenit! U kam lejuar fëmijëve të tij që ta vizitojnë sepse nga përvoja e di se pas disa orëve do të vdesë, në përjashtim të rastit kur

Allahu dëshiron diç tjetër. Ah sikur të jetë e mundur të ndiesh atë që ndien ai duke qajtur si fëmijë, pasi që e di gjendjen e vështirë në të cilën gjendet dhe e di se do të përshëndetet përfundimisht nga familja dhe do të niset për në ahiret! A dëshiron si ai ta ndiesh rrezikun e duhanit?! Vëllai im, a nuk ke zemër?! A nuk ke grua dhe fëmijë?! Kujt do t'ua lësh?! Aq pa vlerë janë për ty sa që i jep përparësi cigares, e cila nuk të sjellë asnjë dobi përveç sëmundjeve dhe dhimbjeve? Pasi i dëgjuam këto fjalë me burrin tim, nuk kaluan disa sekonda dhe ai e hodhi cigaren dhe pakon e cigareve. Ky mjek i sinqertë i tha: "Shpresoj që kjo vepër të mos jetë bërë vetëm për hir tim, bëje këtë vepër sinqerisht për Allah e do të kesh jetë dhe lumturi!!" Pastaj shkoi në veturën e tij. Derisa e përcolla me sy, unë u mbusha vaj dhe filloi të më dridhet zëri. Sa e hapi burri im derën e veturës, shpërtheu vaji im. Fillova të qaj me zë, nuk munda t'i fsheh ndjenjat e mia. Fillova të qaj sikur unë të isha gruaja e atij që ishte i shtrirë në spital nga kanceri dhe i cili do të vdiste pas pak orëve... Kurse burri im u shtang, mbeti pa fjalë, nuk mundi ta ndezë veturën në moment... Filloi ta falënderojë këtë mjek të sinqertë dhe ta lavdërojë me llojlloj lëvdatash, duke i thënë se sa mjek i sinqertë që ishte... Për një kohë isha humbur, nuk munda ta shoqëroj. Mirëpo ky ishte fundi i tij me duhanin. Ia di për nder dhe e falënderoj atë mjek. Për të kam respekt të veçantë dhe për të lutem në çdo namaz dhe në çdo rast. E falënderoj për atë ditë të bardhë, e cila na e zbardhi jetën dhe shpëtuam nga kjo vështirësi. Vazhdimisht do të lutem për te dhe për çdo njeri të sinqertë... Nga ky rast e

mësova vlerën e duasë dhe Fuqinë e Zotit për të ndryshuar gjendjen. Mësova vlerën e durimit, duke shpresuar shpërblim dhe duke u lutur. Mësova të vlerësoj dhuratën e Zotit, i Cili udhëzon, cilin dëshiron Ai. Mësova vlerën e fjalës së sinqeritë. Vallë,

si do të ishte gjendja nëse secili prej nesh do ta kryente detyrën e vet në atë mënyrë dhe me aq sinqeritet siç e kreu ai mjek atë ditë?! Sa e sa probleme do të zgjidheshin?!

Marrë nga revista: "El-Usre", nr. 89
Bedrije Sulejmani

Nëna dhe gruaja e babait

Çdo lutje për bekim dhe pasardhës të mirë. Pas disa minutash do të mbetem e vetmuar duke e thirrë të kaluarën e hershme. Loti, pavërejtur rrëshqiti prej syrit tim. Mu kujtua nëna si i lutej Allahut subhanehu ve teala, të më jep një burrë të mirë. Sikur në ëndërr u ktheva prapë duke kaluar nëpër mendimet e atij viti të gjatë.

Mëngjesi i asaj dite. Ku e kam nënën? Ku ka shkuar? Edhe pse i kam vetëm pesë vjet, zëri im jehoi në dhomë. E përsërita pyetjen: ku e kam nënën? Mu përgjigjen vetëm lotët e mi. Dikush shtoi me zë të ulët, me qajtje të ndërprerë: "Është në Xhennet nëse do Allahu".

Atë ditë nuk dija se kush po qanë më tepër: vëllai im trevjeçarë, njerëzit përreth nesh apo unë? E mora vëllain tim për dore dhe u nisëm për ta kërkuar nënën. Këmbët tona të vogla për një moment u lodhën duke vrapuar andej-këndeje. Hypëm në katin e parë të shtëpisë. I hapëm dyert e dhomave. Shikuam në kuzhinë. Ndonëse u munduam, por atë nuk e gjetëm. Atëherë u vërtetova se nëna nuk është në shtëpi. E kapa vëllain tim dhe filluam të qajmë. Ku ka humbur?

Më në fund e gëzuar mu kujtua. Ka mbetur një vend ku nuk e kemi kërkuar.

Druri i vjetër. Çdoherë kishte dëshirë të qëndrojë nën hijen e tij. Vrapuam nëpër shkallët e shtëpisë. I paaftë që të më përcjellë, vëllai u rrëzua. Mirëpo, në fund e pamë vetëm drurin. Kot shikonim në shportën e gjërë dhe vendin që e kaplonte hija e tij e këndshme. Nëna nuk është.

Papritmas dëgjova thirrjen e disa burrave. Së shpejti kaluan pranë nesh duke bartur diçka në krahërorët e tyre. Vëllai më pyeti se ç'janë duke bartur. Iu përgjigja, me paditurinë e fëmijës: "Kjo është diçka e rëndë sepse të gjithë janë pjesëmarrës në bartjen e saj". Nuk e dija në atë moment se, në realitet, ajo është nëna ime. E sikur ta dija, do të kapesha për të dhe nuk do ta lejoja të shkojë.

Burrat u humbën. Zërat u qetësuan dhe mbisundoi qetësia. Vëllai dhe unë qëndruam ulur në tokë duke luajtur, nën hijen e drurit, sikur atëherë kur nëna ynë ishte aty, afër. Kjo ishte hera e parë që të kishim dalë në kopsht të zbathur, pa këpucë, e që askush të mos na e tërhiqte vërejtjen. Loznim në qetësi deri sa nuk erdhi një grua e familjes tonë dhe na futi brenda.

Agoi edhe dita e re. Prapë e përsëritëm kërkimin duke shikuar në çdo vend. E

lodhur i thashë vëllaut tim i cili ishte duke qajtur: “ajo do të kthehet, do të kthehet!”. Gjyshja jonë vrapoi duke e dëgjuar të qajturit tonë. Më përqafoi dhe e ndjeva lotin e saj në flokët e mia.

Ende më kujtohet dita kur e vizituam nënën tonë në spital. Babai më solli deri te krevati i saj duke thënë: “Ka ardhur Aisheja”. Më përqafoi dhe më puthi, sikur edhe vëllain tim. Lotët i rridhnin nëpër fytyrë deri sa i shtrëngonte duart e mia të vogla. Aq fortë i puthte sa që edhe sot e kësaj dite më kanë mbetur në kujtim. Fjalët e fundit që i dëgjova prej saj ishin: “Po u dorëzoi te Allahu i cili nuk e tradhëton atë që i është besuar”. Mandej qau shumë duke e mbuluar fytyrën. Dolëm prej dhomës së saj duke qajtur.

Kaluan pesë vjet prej asaj kohe. Një ditë u kthyem në shtëpi me vëllain tim pas një vizite që ia bëmë gjyshes. Në shtëpinë e babait tim ishte ulur një grua e panjohur. Ai tha: “Kjo është Esma. Përshëndetuni me të”. Nuk më ishte nënë, por me të vërtetë ishte grua e mirë për babain tim. Kujdesej për edukimin tonë të mirë. E përcillte mësimin tim me kujdes. Mua dhe vëllaut tim na jepte çdo gjë që dëshironim, bile edhe më tepër. Shpeshherë dinim ta hidhërojmë me veprimet tona, por ajo ishte grua e kuptueshme dhe durimtare. As një minut të jetës së saj nuk e kalonte në gjëra të kota. Gjuha e saj çdoherë ishte e lagur me përmendjen e Allahut subhanehu ve tealë. E kishte përmbledhur në vete besimin dhe sjelljen e mirë, ashtuqë arriti ta plotësojë zbrastirën e madhe në jetën tonë.

Njëherë e pyeta: “Ku është ajo turturë dhe sjellje e keqe me të cilat veçohen gratë e baballarëve (njerkat) ndaj fëmijëve të burrave të tyre”, ajo mu

përgjigj: “Unë kam frikë prej Allahut subhanehu ve tealë, dhe pres shpërblimin prej Tij për çdo punë të mirë. Ju më jeni besuar si emanet. Mos u habit! Edhe deri sa t'i kreh flokët, pres shpërblim për këtë. Aishe, sa din t'i prej Kur'anit përmendësh? A nuk kam unë shpërblim për këtë? A nuk kam shpërblim për edukimin tënd të mirë? Gjithë këtë e bëj vetëm për të kërkuar shpërblim prej Allahut subhanehu ve tealë,”.

Mandej shtoi: “Sikur çdo njeri që kërkon shpërblim dhe sevape për ibadetet që i bën, siç është namazi dhe agjërimi, po ashtu duhet kërkuar shpërblimin edhe në sjelljet e mira, sepse ne do të pyetemi për to”. E ndërpreva: “Por ne të shqetësojmë dhe të lodhim”. Ajo tha: “Aishe, çdo punë e vështirë ka edhe shpërblim. Xhenneti e ka çmimin e tij. Edhe vetë e di se agjërimi në vete sjell lodhje trupore. Po ashtu edhe haxhi. Por Allahu subhanehu ve tealë, thotë: “Kush bën një punë të mirë edhe sa një grimcë, do ta sheh, e kush bën të keqe edhe sa një grimcë, do ta sheh”. Atë që e sheh nga arroganca e grave tjera, nuk mund të kalojë pa llogari”. Unë i thashë: “Në sjelljet e tua ndaj nesh pashë pranimin e lutjes që e bëri nëna ime. Me të vërtetë Allahu nuk e lë pasdore atë që i besohet”.

Papritmas u dëgjua rrahja e derës. Hyri babai tim. Na përshëndeti me selam dhe unë e putha në ballë. Gruaja e babait vazhdoi këshillën: “Mos harro të presësh shpërblim për çdo punë që do ta bësh”. Ndërsa biseda përfundoi me fjalët: A e di se Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: ‘Nëse gruaja i falë pesë kohët e namazit, agjëron muajin e Ramazanit, e mbron nderin e saj dhe e respekton

burrin, do t'i thuhet: Hyn në Xhennet nga cila derë të duash'.

E tani erdhi koha e praktikimit.

Thashë në vete: "Nuk gaboi babai im kur u martua me këtë grua të mirë. Nuk ka gabuar babai im kur u martua me grua e cila i frikohet Allahut subhanehu ve teala.

Prej librit "Zemenu-l-kadim"

Redaktoi: O. B.

Muhammed Isma'il Es Selefi

(dijetar i palodhshëm në shërbim të Islamit në subkontinentin indian)

Ka lindur në vitin 1314 H në fshatin Duhunki në familje e cila dallohej me zbatim të përpikt të mësimave fetare. Prej moshës së re filloi kërkimin e diturisë duke e patur për mësues të parë atin e tij. Pas mësimave fillestare vazhdoi kërkimin e dijes duke udhëtuar për takim me dijetarët e asaj kohe në Indi. Ishte prej të parëve që inicuan formimin e lëvizjes "Ehlul Hadith" (Pasuesit e hadithit) në Indi dhe pastaj në Pakistan. Gjurmet e ndikimit të tij shihen qartë në jetën fetare dhe politike të asaj periudhe.

Prej posteve që i ushtroi ishte edhe ai i hatibit në xhaminë e "Ehlul Hadithit" në Kexhranvale si dhe ai i profesorit në "El Xhami'a El Muhammedijje" (Universiteti El Muhammedijje).

Ishte edhe sekretari i përgjithshëm i komisionit për punë pranë asamblesë së përgjithshme të lëvizjes "Ehlul Hadith" në Nju Delhi.

Pas ndarjes mes Pakistanit dhe Indisë u bë sekretar i përgjithshëm pranë shoqatës me të njejtin emër që vepronte brenda Pakistanit deri në fund të jetës në vitin 1968 G.

Vepronte zellshëm edhe në komisionin ekzekutiv të shoqatës "Hatemun Nubuve"

(Vula e Pejgamberisë) që luftonte sektën kadjanije si dhe në "El Vefd Et Teblig" (Delegacioni Kuntues) që rezistonte veprimtarinë e hindusëve për konvertimin e myslimanëve në hinduizëm në krahinën Melkanun.

Inicoi ndërtimin e vendbanimeve të shumta ku do të shtrehohen myslimanët e debuar prej Indisë pas ndarjes prej Pakistanit, si dhe ndërtimin e xhamive dhe medreseve. I ndikuar prej mësuesit të tij Ebu Kelam Azad nuk mungoi as angazhimi i tij politik që u spreh me kërkes prej qeverisë së Pakistanit të vendos shtet Islam që do të gjykon me sheriatin Islam. Në vitin 1952 G u zgjodh si anëtar na komisionin që do të përpilonte kushtetuten Islame për Pakistanin.

Ka shkruar edhe shumë libra prej të cilëve më i rëndësishëm është përkthimi i përmbledhjes me hadithe "Mishkatul Mesabih" të Imam Tebrizit në gjuhën urdu dhe komentimin e tyre.

Ditën e martë, më 20 Dul Ka'de të vitit 1387 H (20/02/1968 G) ndërroi jetë ky dijetar që përhapi metodologjinë e dijetarëve të hadithit në Indi dhe punoi në shërbim të popullit dhe për të miirën e tij. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjerë. Amin.

Përshtati: Talha Kurtishi

23.9.2006

Muaji Ramazan

Këtë muaj e njeh secili besimtar, sepse është mysafir i cili pritet me padurim dhe për të cilin flitet mjaft qysh para se të vijë, kur të vijë dhe kur të shkojë po ashtu. Pasi që biseda rreth tij për asnjërin nga myslimanët nuk është e mërzitshme, do të mundohemi që të bëjmë një përkujtim të shkurtër, njoftim me këtë mik të begatshëm me shpresë se nga ky tekst të ketë dobi çdo njëri që e lexon.

Tek ne njihet si Ramazan, e në të vërtetë ai quhet Ramadan, nga fjala "رمضان – ramdaë" që d.m.th. nxehtësi e madhe. U quajt ashtu sepse emërtimi i tij ndodhi në periudhën më të nxehtë të vitit.

Disa mirësi të këtij muaji

1. Era e pakëndshme e gojës së agjëruesit, tek Allahu, subhanehu ue teala, është më e këndshme se era e miskut.

2. Melaqet kërkojnë falje për agjëruesit derisa të bëjnë iftar.

3. Shejtanëve u vihen prangë.

4. Dyert e xhenetit hapen, ndërsa dyert e xhehenemit mbyllen.

5. Në këtë muaj gjendet nata e kadrit, që është më e mirë se një mijë muaj. Kush privohet nga mirësia e saj, është privuar nga mirësia në përgjithësi.

6. Shpresohet që në ditën e fundit, agjëruesit t'i falen të gjitha mëkatet, si pagim i veprave të mira gjatë muajit.

7. Në çdo natë, Allahu zgjedh njerëz që do ti lirojë nga Zjarri.

Një muaj, i cili ka këto mirësi, a thua vallë si duhet ta presim?! Dhe kur të arrijë si duhet të sillemi në të. Myslmani i mirë, këtë

muaj e pret me pendim të sinqertë, me vendosmëri të fortë se do ta shfrytëzojë maksimalisht dhe do ta mbushë kohën e tij me punë të mira... Allahu na ndihmoftë që ta adhurojmë sa më mirë!

Veprat që janë obligim apo preferohen gjatë këtij muaji

1. Agjërimi. Resulullahu, alejhi selam ka thënë: "Çdo vepër e birit të Ademit është për të. Një e mirë shpërblehet dhjetëfish deri në shtatëqind fish. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: përveç agjërit, sepse ai është për Mua dhe unë shpërblej për te. Ka lënë epshin, hajen dhe pijen vetëm për hir Timin. Agjëruesi ka dy gëzime, njëri është kur të çelë iftar dhe tjetri kur të takohet me Zotin e tij. Vërtetë, ajo erë e pakëndshme në gojën e agjëruesit është më e mirë se era e miskut". (Buhariu dhe Muslimi). Po ashtu ka thënë: "Kush agjëron Ramazanin me besim dhe shpresë për shpërblim, i falen të gjitha mëkatet e bëra". (Buhariu dhe Muslimi)

Ky shpërblim i madh duhet ta dimë se nuk arrihet vetëm me agjërimin ndaj hajes dhe pijes, agjërimi duhet të jetë ashtu si na ka mësuar Resulullahu, salallahu alejhi ue selem: "Kush nuk largohet nga fjalët e rreme, veprimet sipas tyre dhe nga injoranca, le ta dijë se Allahu nuk ka nevojë që ky njeri të braktisë hajen dhe pijen". (Buhariu)

2. Namazi vullnetar

I dërguari i Allahut, alejhi selam ka thënë: "Kush e kalon Ramazanin në këmbë (duke u falur), me besim dhe shpresë për shpërblim,

i falen të gjitha mëkatet e bëra". (Buhariu dhe Muslimi)

Kjo është vërejtje me rëndësi, duhesh o mysliman i nderuar që t'i falësh teravitë me imamin, që edhe ti të shënohesh me ata që kanë qëndruar në këmbë për të falur namaz. Resulullahu, alejhi selam po ashtu ka thënë: "Kush falet me imamin deri në fund, i numërohet sikur të jetë falur tërë natën". (Katër sunenet)

3. Sadakaja

I dërguari i Allahut çdo herë ka qenë bujar, por edhe më bujar ishte gjatë Ramazanit, ai ishte bujar në mirësi edhe më shumë se era e cila përfshin çdo vend. Ai ka thënë: "Sadakaja më e vlefshme është në Ramazan". Ky adhurim ka shumë dyer dhe bëhet në disa mënyra:

a. Dhënia ushqim të tjerëve. Allahu, subhanehu ue teala, ka thënë: "Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robë. Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të Allahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim. Ne i frikësohemi (dënimit të) Zotit tonë në një ditë që fytyrat i bën të zymta dhe është shumë e vështirë. Po Allahu i ruajti ata prej sherrit të asaj dite dhe u dhuroi shkëlqim në fytyra e gëzim të madh. Dhe për shkak se ata duruan, i shpërbleu me xhenet dhe me petka mëndafshi". (Insan 8-12).

Mirë është të dihet se për tu fituar shpërblimi nuk është kusht që personin të cilin e ushqen të jetë i varfër. Resulullahu, alejhi selam ka thënë: "Cilido nga besimtarët që ushqen një besimtar të uritur, Allahu do ta ushqejë këtë njeri me fryte nga xheneti, dhe cilido i jep ujë një besimtarit, Allahu do t'i jep të pijë nga nektari i vulosur". (Tirmidhiu me zinxhir hasen)

b. Përgatitja iftar për agjëruesit

Resulullahu, alejhi selam ka thënë: "Kush i jep iftar një agjëruesit, do të fitojë edhe shpërblimin e tij, duke mos u pakësuar asgjë nga shpërblimi i agjëruesit". (Ahmediu, Nesaiu. Albani thotë se është sahih)

4. Leximi sa më i shumtë i Kuranit

Kujdesu që të lexosh librin e Allahut me meditim dhe përvullje. Resulullahu, alejhi selam ka thënë: "Shembulli i besimtarit që lexon Kur'anin është sikurse shembulli i qitrosë, ka erë të mirë dhe shije të mirë, shembulli i besimtarit që nuk lexon Kur'an është sikurse shembulli i hurmës së thatë, nuk ka erë por ka shije të ëmbël. Shembulli i munafikut që lexon Kur'an është sikurse shembulli i borzilokut, e cila ka erë të mirë e shije të idhët, ndërsa shembulli i munafikut i cili nuk e lexon Kur'anin është sikurse shembulli i kungullit të thatë, nuk ka erë dhe shijen e ka të idhët". (Buhariu dhe Muslimi)

5. Ndeja në xhami derisa të lindë dielli

Resulullahu, alejhi selam ka thënë: "Kush e falë namazin e sabahut me xhemat, pastaj ulet të bëjë dhikër (përmend Allahun) derisa të lind dielli, e kur të lind dielli i falë dy rekate, shpërblimin e ka sa një haxh dhe umre të plotë, të plotë, të plotë". (Tirmidhiu, e Albani e vlerësoi për sahih)

6. Itikafi (mbyllja në xhami)

Kjo bëhet me qëllim që njeriu të ndahet përkohësisht nga kjo botë, të meditojë më tepër sa është duke i kryer obligimet ndaj Allahut, të kërkojë falje, të ripërtërijë lidhjet e tij me Allahun, dhe ta arrijë natën e kadrut duke qenë si besimtar më i mirë. Resulullahu, alejhi selam gjatë Ramazanit qëndronte dhjetë ditë i mbyllur në xhami, ndërsa në vitin kur ndërroi jetë, kishte qëndruar njëzet ditë". (Buhariu)

7. Umreja gjatë Ramazanit

Ajo është vizita e Qabesë, për të bërë tavaf rreth saj, ecja mes kodrave Safa dhe

Merva dhe rrojta apo shkurtimi i flokëve. I dërguari i Allahut ka thënë: "Një umre në Ramazan është e barabartë me një haxh". (Buhariu dhe Muslimi)

8. Dhënia e mundit për të takuar natën e kadrit

Duhet dhënë mund sepse kjo natë ka më shumë vlerë se një mijë muaj. Tregohet se Ajsheja radijallahu anha, kishte pyetur: O i dërguar i Allahut, nëse e takoj natën e kadrit, çfarë (lutje) të them? Tha: thuaj: "O Allahu im, ti je Falës, e do faljen, më fal mua". (Ahmed, Tirmidhi)

9. Vërejtje dhe gabime nga të cilat duhet larguar

- bërja e natës ditë dhe ditës natë
- gjumi gjatë kohës së namazeve
- teprimi në haje dhe pije
- humbja e kohës
- ngrënia e syfyrit herët
- voztija e shpejtë para iftarit
- mos falja e teravive aq sa falet imami
- ndeja e të rinjve nëpër rrugë për biseda të kota apo mëkate
- shfrytëzimi i Ramazanit për organizim të turneve apo garave sportive
- angazhimi i tepërt i gruas në kuzhinë etj.

Për të mos e zgjatur më tepër, kalojmë në pikën e fundit të temës: raste nga historia që kanë ndodhur në këtë muaj:

1. Në datën 17 të vitit 2 H (623 G) ishte lufta më e njohur në Islam, lufta e parë mes myslimanëve dhe jomyslimanëve. Triumfi ishte për myslimanët dhe këtu u pa se edhe myslimanët kanë forcë dhe dinë të mbrohen. Kjo luftë ishte nën udhëheqjen e komandantit më të lartë të njerëzisë, Muhamedit, salallahu alejhi ue selem.

2. Në datën 10 të vitit 8 H (630 G), Resulullahu, alejhi selam së bashku me

shokët e tij u nis për të çliruar Mekën dhe ky vit u quajt viti i Çlirimit. Kjo ngjarje ishte si kurorëzim i mundit të Resulullahut, alejhi selam në thirrje (da've) dhe ishte lajmërim i udhëheqjes Islame në gadishullin Arabik.

3. Në datën 26 të vitit 9 H (631 G), Resulullahu, alejhi selam u kthye prej betejës së Tebukut. Në këtë betejë kishin munguar disa shokë të tij e kur erdhi në xhami u arsyetua kush u arsyetua, e këtu ndodhi ngjarja e bojkotimit të Ka'b ibën Malikut dhe dy shokëve të tij, radijallahu anhum.

4. Në datën 17 të vitit 40 H (660 G), ra shehid imam Aliju, halifi i katërt i myslimanëve. Ishte fëmija i parë që kishte pranuar Islamin, mori pjesë në të gjitha betejat me Resulullahun, alejhi selam u martua me vajzën e tij Fatimen dhe u bë i njohur me trimërinë dhe oratorinë e tij.

5. Në datën 28 të vitit 92 H (711 G), ishte beteja e Vadi Lukke midis myslimanëve, të cilët i udhëhiqte Tarik ibën Zijadi dhe jomyslimanëve, të cilët i udhëhiqte Lederik. Fitimtarë ishin myslimanët. Kjo fitore bëri që Islami të hyjë në Spanjë dhe të bëhet një shtet Islam që do të zgjasë tetë shekuj me radhë...

6. Në datën 30 të vitit 256 H (869 G), ndërroi jetë Muhamed ibën Ismail ibën Ibrahim ibën Mugire, i njohuri Imam Buhari. Ai është i myslimanëve në hadith, autori i librit "Sahihul Buhari", i cili është libri më i vërtetë pas Kuranit. Ai shkroi po ashtu "Tarihul kebir", "Edebul mufred" etj.

7. Në datën 25 të vitit 658 H (1260 G), ndodhi beteja Ajn Xhalut, në Palestinë, midis myslimanëve me udhëheqësin Sejfudin Kutuz dhe mongolëve me udhëheqësin e tyre Kitubuka. Fitorja ishte e myslimanëve. Ajo realizoi një shpëtim madhështor, stopoi

vërsuljen e herëpashershme të mongolëve dhe zgjoi qytetërimin Islam nga shkatërimi.

8. Në datën 4 të vitit 927 H (1521 G), osmanët arrijnë të çlirojnë Beogradin, i cili ishte çelës i Evropës së mesme dhe në të ishte kalaja më e fortë midis në kufirin osman-hungarez.

9. Në datën 15 të vitit 1224 H (1809 G), osmanët triumfojnë kundër Ruisë në

betejën Tatarixhe. Aty vriten 10 000 ushtarë rus.

10. Në datën 21 të vitit 1275 H (1859 G), filluan gropimet për hapjen e kanalit të Suezit. Gropimi zgjati dhjetë vite e gjysmë me pjesëmarrje të 60 000 punëtorëve.

11. Në datën 27 të vitit 1403 H (1983 G), në Katar u hap banka e parë islame me emrin "Banka Islamike e Katarit" me një fond prej 200 milion rijal të Katarit.

përgatiti dhe përshtati:
Omer Berisha

Besimi në pejgamberët e Allahut

Besimi në pejgamberët e Allahut është një prej shtyllave të imanit. Kjo shtyllë nënkupton: të besuarit e prerë se Allahu, subhanehu ve teala, ka zgjedhur pejgamberë për kumtimin e shpalljes së Tij. Kush i pason ata, udhëzohet, kush i kundërshton, humbet. Ata e kumtuan shpalljen e Zotit në mënyrë të qartë, e çuan amanetin në vend, këshilluan ummetin dhe u përpoqën për hir të Allahut sinqerisht. Ata i sollën argumentet, asgjë nuk ndryshuan e as që fshehën. Kjo shtyllë e imanit nënkupton edhe atë se duhet besuar pejgamberët të cilët i njohim me emra si dhe ata të cilëve nuk ua dimë emrat. Çdonjëri prej pejgamberëve ka përgëzuar popullin e tij me pejgamberin që do të vinte më pas, kurse çdo pejgamber ka vërtetuar lajmin e pejgamberëve të mëhershëm. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Ju (besimtarë) thuani: "Ne i besuam Allahut, atë që na u shpall neve, atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve (të Jakubit që ishin të ndarë në dymbëdhjetë kabile), atë që i është dhënë Musait, Isait dhe atë që iu është dhënë nga Zoti i tyre pejgamberëve, ne nuk bëjmë dallim në asnjërin prej tyre dhe ne vetëm atij i jemi bindur." (Bekare – 136)

Ai që përgënjeshtroi një pejgamber, ai ka përgënjeshtuar Atë i cili vërtetoi të njëjtin, po ashtu ai që kundërshtoi pejgamberin, ai ka kundërshtuar Atë i cili dha urdhër për respektimin e tij. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "S'ka dyshim se ata që nuk besojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij, dëhirojnë të bëjnë dallim mes Allahut dhe të dërguarve të Tij e thonë: "Ne i besojmë disa e nuk i besojmë disa të tjerë" e mes këtij duam të marrin një rrugë. Të tillët lanë jobesimtarët e vërtetë; e Ne kemi përgatitur dënim të fortë e nënçmues për jobesimtarët." (Nisa – 150,151)

Realiteti i pejgamberllëkut:

Pejgamberllëku është lidhja mes Krijuesit dhe krijesave për kumtimin e Ligjit hyjnor. Allahu kë të dojë prej robërve të Tij e nderon me pejgamberllëk. Asnjërit nuk i takon zgjedhja e atij që do të jetë pejgamber përpos Allahut. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Allahu zgjedh të dërguar prej engjëjve dhe prej njerëzve, Allahu dëgjon e sheh." (Haxh – 75)

Pejgamberllëku pra dhurohet e nuk përfitohet, nuk arrihet me adhurime të shumta, nuk vjen me zgjedhjen e vet pejgamberit apo me kërkesën e tij porse është zgjedhje prej Allahut, subhanehu ve teala. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Allahu veçon për të (për besim të drejtë) atë që do dhe e udhëzon në të atë që i drejtohet Atij." (Shura – 13)

Urtësia e dërgimit të pejgamberëve:

Urtësitë e dërgimit të pejgamberëve janë të shumta, prej tyre:

a) largimi i njerëzve nga adhurimi i krijesave në adhurimin e Krijuesit, nga robëria e njerëzve në lirinë e adhurimit të Zotit të njerëzve. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "E Ne të dërguam ty (Muhammed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat." (Enbija – 107)

b) njoftimi i njerëzve më qëllimin e krijimit të tyre e që është: adhurimi i Allahut, njësimi i Tij, një gjë që nuk mund të mësohet vetëm se nëpërmjet pejgamberëve të cilët Allahut, subhanehu ve teala, i zgjodhi dhe i mbivlerësoi ndaj krijesave tjera. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Ne dërguam në çdo popull të dërguar që t'u thonë: "Adhuroni vetëm Allahun, e largojuni djajve (adhurimit të tyre)!" (Nahël – 36)

c) sjellja e argumenteve me dërgimin e pejgamberëve. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Të dërguar që ishin lajmgëzues e kërcënues, ashtu që pas dërgimit të dërguarve njerëzit të mos kenë fakt (arsyetim) para Allahut. Allahu është i pavarur në sundimin e vet dhe di si të veprojë." (Nisa – 165)

d) sqarimi i disa gjërave të fshehta që nuk mund të kapen me mendjen e njeriut siç janë: emrat dhe cilësitë e Allahut, melekët, Ahireti e tjerë.

e) të qenit e pejgamberëve shembëlltyrë. Ata i plotësoi Allahu, subhanehu ve teala, me virtyte të larta dhe i mbroi nga dyshimet dhe epshet e shejtanit. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Ata (të dërguarit e përmedur) ishin që Allahu i vuri në rrugë të drejtë, andaj ti merri shembull në udhëzim." (En'am – 90), poashtu thotë: "Vërtetë, për atë që ka shpresë në Allahun dhe në ditën e gjykimit, ju keni mostër të mire." (Mumtehane – 6)

ë) përmirësimi dhe pastrimi i shpirtave si dhe mbrojtja e tyre nga çdo gjë që i komprometon ato. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t'ua lexojë ajetet e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë librin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme." (Xhum'a – 2)

Poashtu Pejgamberi sal ka thënë: " jam dërguar që t'i përsos virtytet morale."

Vazhdon...

Përgatiti: Agim Bekiri

Një ulje me dijetarin e madh Nasirudin Albanin

Si ta kuptojmë thirrjen në metodologjinë e të parëve tanë selefë salih

Pyetje: Si ta kuptojmë thirrjen në suaza të metodologjisë selefite pasi që sot shumë janë që pretendojnë se janë selefë a ndodh që të ketë mosmarrëveshje në disa çështje, për këtë shkak patjetër duhet të kuptojmë domethënien e përgjithshme të davetit selefë.

Përgjigje: Së pari thirrësit e davetit selefë duhet t'i njohin njerëzit në përgjithësi njësoj qofshin ata thirrës apo që thirren. Duhet atyre t'ua bëjnë të njohur realitetin e thirrjes islame selefite e cila dallohet në vërtetësinë e saj nga të gjitha thirrjet tjera me origjinë islame.

Të gjitha thirrjet islamike, të parat dhe ato bashkëkohore i kanë përvetësuar Kur'anin dhe sunetin (si bazë për fe), përpos disa xhimateve në kohën e sotit dhe disa individë në kohërat e kaluara të cilët kanë thënë se thirrja e tyre bazohet vetëm në Kur'an pa sunetin. E dihet se dijetarët janë unanimitë se ai që mjaftohet për kuptimin e fesë islame vetëm në Kuran, nuk është musliman, sepse vetë Kur'ani i urdhëron muslimanët që ta respektojnë Allahun dhe të dërguarin e Tij dhe gjithashtu gjykimin ta kërkojnë prej Allahut dhe të dërguarit të Tij.

Ne nuk e kemi qëllimin të ndalemi në këtë pikë, sepse ata që i përkasin kësaj metodologjie janë në konfrontim me Kur'anin dhe sunetin. Ata quhen kuranijun dhe devijimi i tyre është i qartë. Mirëpo të gjitha xhematet tjera që me strukturën e tyre takohen në unionin e suazave të islamit së bashku me ne janë në bazimin në Kur'an dhe sunet, por thirrësit selefë veçanërisht duhet tu sqarojnë këtyre se daveti selefë dallohet nga të gjitha thirrjet me atë se ata e kuptojnë Kur'anin dhe sunetin ashtu siç kanë qenë të parët tanë të mirë selefë salih nga sahabët, tabi'inët dhe tabiutabi'inët siç ka ardhur në hadithin e trashëguar nga Pejgamberi salallahu alejhi ve selem ku ka thënë: Njerëzit më të mirë janë gjenerata ime, pastaj ata që vijojnë, pastaj ata që vijojnë.

Ne i bashkangjitem Kur'anit dhe sunetit, metodologjinë e selefë salih (për t'i kuptuar ato) dhe kjo shtesë nuk është gjë e re (e shpikur) që të dyshojnë njerëzit, por kjo është e theksuar në Kur'an dhe sunet. Në Kur'an është thënia e Allahut të madhëruar: "Kush i kundërvihet të dërguarit, pasi që i është bërë e qartë e vërteta dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë në atë që e ka zgjedhur (në Dunja) dhe e fusim në xhehenem. Përfundim i keq është ai". Nisa 115

E sa i përket sunetit janë dy hadithe të njohura. Njëra prej tyre është hadithi për grupin e shpëtuar në të cilin është pyetur i dërguari se kush janë grupi i shpëtuar? Është përgjigjur me fjalët: ata që do të jenë (në fe) siç jamë unë dhe as'habët e mi.

Hadithi i dytë është hadithi i hulefave rashidin nga Irbad ibën Sarije se i dërguari salallahu alejhi ve selem ka thënë: kapuni për sunetin tim dhe sunetin e hulefave rashidin el-

mehdijin pas meje ... në këtë hadith ka sqarim për rrugën e besimtarëve që është përmendur në Ajetin: "Kush i kundërvihet të dërguarit, pasi që i është bërë e qatë e vërteta dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë në atë që e ka zgjedhur (në Dunja) e e fusim në xhehennem. Përfundim i keq është ai". Nisa 115

Domethënë se thirrësit duhet të bisedojnë rreth kësaj çështje të dalluar të thirrjes së vërtetë dhe triumfuese të grupit të shpëtuar ndaj frakcioneve. Ai dallim (ajo çështje) është se duhet të jenë ashtu siç kanë qenë selefut salih.

Kjo kërkon që kjo rregullore të praktikohet në metodologjinë e ehlu sunetit dhe njëkohësisht kërkon nga thirrësit selefij të interesohen për njohjen e gjurmëve të parëve tanë ashtu siç interesohen për njohjen haditheve profetike, sepse njohja e këtyre gjurmëve janë ato që ua realizojnë zbatimin e kësaj metodologjie me zbatim praktik dhe të vërtetë.

Mirëpo në këto gjurmë (siç është në hadithe) ka që janë sahih dhe ka daif. Këtu duhet pasur vëmendje në atë që do ta them: Ne kur themi se filan sahabi ka thënë kështu apo ka bërë kështu, këtë e konsiderojmë sqarim të ajetit apo të ndonjë hadithit. Kjo do të thotë se ne duhet ta kemi të qartë vërtetësinë e atij etheri (gjurmë). Kështuqë thirrësi musliman selefij duhet të mbështetet në diturinë në lidhje me këtë së pari, dhe në thirrjen dhe qartësimin e metodologjisë që i përket së dyti.

Daveti selefijit dallohet me përpjekjen e saj për njohjen e vërtetë të islamit në të gjitha aspektet, e jo siç veprojnë disa xhemate që kapen dhe (kinse) kontribuojnë në disa aspekte. Arsyetohen duke thënë se disa gjëra janë prioritare. Kjo i ka shpjerrë në ndarjen e fesë islame (apo diturisë rreth islamit) në atë që ta bëjnë në dy pjesë: fryti dhe lëvorja. E këta (kinse) kujdesen dhe interesohen (në të vërtetë as në këtë aspekt nuk interesohen) për frytin (thelbin), e nuk interesohen për pjesën tjetër (lëvoren).

Unë e kam tërhequr vërejtjen në një realitet shkencor. Njeriu musliman që është i mbështetur në dituri, do ta ketë të qartë se nuk mundet aspsolutikisht t'i del dijetarit hulumtues në Kur'an dhe sunet (e të bën) ndarje të islamit në thelb dhe lëvore.

Ne nuk i dorëzohemi këtyre termeve të themi se islami është thelb dhe lëvore, por themi se ka gjëra që së pari patjetër duhet të dihen e pastaj së dyti patjetër të realizohen në praktikë.

Ka edhe gjëra tjera që patjetër duhet të dihen shkencarisht sa u përket një grupit të njerëzve që janë nga dijetarët. Kjo është që e quajnë dijetarët farz kifaje. Nga ana fetare me këtë term ngërthehen gjërat që detyrimisht duhet t'i zbaton një grup dhe nuk e kanë obligim individët tjerë të shoqërisë islame.

Pastaj, nga ajo që ka ardhur në sunet se ajo çka nuk është vaxhib, mund të jetë ndihmës për atë që ka lënë mangut në ndonjë vaxhib. Me këtë aludoj në hadithin e njohur nga i dërguari salallahu alejhi ve selem se ka thënë: gjëja e parë për të cilën do të llogaritet robi (njeriu) në Ditën e Gjykimit është namazi, nëse është i plotë, ka shpëtuar dhe ka kaluar, e nëse është mangut, ka mbaruar dhe është shkatërruar. Në hadith tjetër ka ardhur: nëse është mangut, do tu thotë Allahu i madhëruar melekëve: shikoni a ka robi im nga (namazi) vullnetar e t'ia plotësoni farzin me të. Domethënë se (ibadeti) vullnetar që nuk është farz, nuk duhet muslimani ta anashkalon me pretendim se nuk është farz. Besimtari që e zbaton një farz, atë duhet ta bëjë në formën më të përsosur, e jo të mangut siç e ka vërejtur i

dërguari salallahu alejhi ve selem në hadithin e njohur të atij që nuk është falur si duhet. Aty thuhet se Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, ka qenë ulur në xhami me as'habët e ka hyrë një njeri dhe është falur. Pastaj ka ardhur te Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, dhe e ka përshëndetur paqja qoftë mbi ty o i dërguar i All-llahut. I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, tha: dhe mbi ty qoftë paqja, por kthehu e falu se ti nuk u fale. Kështu u përsërit tre herë. Ai e përsëriti tre herë namazin e i dërguari salallahu alejhi ue selem, i thoshte: kthehu e falu se ti nuk u fale. Në fund, pasi e vërejti se ai nuk po di të falet, tha: vallahi o i dërguar i Allahut unë nuk di ndryshe, pra më mëso. I dërguari salallahu alejhi ue selem, i tha: kur të ngritesh për ta falë namazin, merr abdes ashtu siç të ka urdhëruar Allahu, pastaj thirre ezanin, pastaj bëne ikametin, pastaj kthehu ka kibleja, pastaj merr tekbir, ... kështu deri në fund të hadithit.

Çka mendoni, a thua vallë të gjithë muslimanët sot janë të bindur dhe padyshim në vetën e tyre se e falin namazin e përsosur dhe se nuk kanë nevojë në Ditën e gjykimit kur të peshohen veprat me peshoren e sakt, se nuk do të gjejnë mangësi në namazet e tyre?!

Ne, ashtu siç po shohim nëpër xhami dhe vende tjera, shumica e njerëzve falen, por nuk falen. Këtu del në shesh se sa duhet patur kujdes në sunetet, sepse ato janë rezervë për jetën shpirtërore dhe të besimit. Këto sunete do të jenë shkak për ta përmbushur ndonjë mangësi që mund të bjen në farz.

Kjo mungesë mund të jetë dy lloj. Mungesë në sasi dhe mungesë në cilësi. Mund t'i shpëton njeriut ndonjë namaz pa arsye të arsyeshme. Kështu ai jo vetëm që ka bërë mëkat, por edhe ka humbur shpërblim të madh. Kjo është mungesa e parë.

Mungesa e dytë, në cilësi, siç tregon hadithi për atë që nuk dinte të falej. Ai falej, por mangësonte nga ruknet po edhe nga forma në përgjithësi. Kështu që në këtë hadith vjen ajo që e ka thënë pejgamberi salallahu alejhi ue selem, nga Zoti i madhëruar se u thotë melekëve: shikoni a ka robi im nga (namazi) vullnetar e t'ia plotësoni farzin me të.

Domethënë, pa marrë parasysh a ka qenë mangësia në sasi apo cilësi. Prandaj islami duhet të njihet dhe të kuptohet (të mësohet) nga të gjitha aspektet pa dallim, siç e përmendëm më parë në shprehjen tonë ç'është farz dhe nafile (vullnetar) a në shprehjen e tyre thelb dhe lëvore.

Në vijim njerëzit gjegjësisht besimtarët duhet të kuptojnë sipas mundësive të tyre pjesën e parë e cila është nga farzet ajn.

E them këtë sepse shumë vetë sot (me thëniet e tyre) qëndrojnë me ne në këtë thirrje, në Kur'an dhe sunet, e pastaj ndahen nga ne duke i braktisur dhe neglizhuar gjurmët e të parëve tanë dhe metodologjinë e tyre. Shumë nga këta kujdesen për ngritjen e shtetit islamik. Kjo detyrë është obligim, ska dyshim në të dhe nuk konfrontohen as dy vetë për këtë çështje. Mirëpo parashtrohet pyetja: cila është rruga për ngritjen e këtij shteti islamik dhe realizimin e qeverimit me islam të bazuar në Kur'an dhe Sunet? A thua është me injorancë, apo me njohjen dhe kuptimin e plotë e pastaj me thirrje në zbatimin e saj siç patë filluar Resulullahu, salallahu alejhi ue selem, me mësimin e njerëzve teuhidin – akiden e vërtetë, e pastaj siç edhe dini ju vetë, e kjo nuk ka nevojë për zgjerim. Ligjet e sheriatit kanë filluar një pas një nga obligimi i namazit, obligimi i agjërimit, e më e fundit që u bë obligim ishte Haxhi për në shtëpinë e shejtë, e pastaj ligjet tjera nga ndalesat, haramet, ndëshkimet sheriatike etj.

Andaj daveti- thirrja islame duhet të jetë e plotë, a zbatimi është sipas mundësive. Prgatitja për ngritjen e shtetit bëhet me punë sipas së cilës e kemi mësuar nga feja e vërtetë.

Zgjodhi dhe përshtati
Ali Shaban Tanusha

Pyetje dhe përgjigje

Namazi i teravisë

Numri: 187

Pyetja: Ç'është dispozita për namazin e teravisë dhe sa rekate i ka?

Përgjigja: Namazi i teravisë është prej suneteve që na i ka lënë Resulullahu, salallahu alejhi ue selem.

Në dy Sahihët nga Ajsheja, radijallahu anha, transmetohet se Resulullahu, alejhi selam një natë u falë në xhami, dhe me të u falën edhe njerëzit, ditën e nesërme u falë përsëri e njerëz kishte më tepër, pastaj u mblodhën edhe më shumë në natën e tretë apo të katërt, e Resulullahu, alejhi selam nuk doli për tu falur me ta, në mëngjes u tha: “Mbrëmë pashë se jeni mbledhur, dhe nuk më ka ndalë asgjë që të vi të falem me ju përveçse frika se do t’ju obligohet ky namaz”. Kjo ndodhi në Ramazan.

E sa i përket numrit të rekateve: themi se është njëmbëdhjetë rekate, duke u bazuar në hadithin në dy sahihët nga Ajsheja, radijallahu anha, të cilën e kanë pyetur se si ka qenë namazi i Resulullahut, alejhi selam gjatë Ramazanit? Ajo ka thënë: As në Ramazan e as jashtë tij nuk shtonte më tepër se njëmbëdhjetë rekate”.

Nëse i fal trembëdhjetë rekate, nuk prishë gjë, ngase Ibën Abasi, radijallahu anhu, ka thënë: “Namazi i Resulull-llahut ,sal-lall-llahu alejhi ue sel-lem, ishte trembëdhjetë rekate”, d.m.th. namazi i natës. Transmeton Buhariu.

Falja e teravive njëmbëdhjetë rekate po ashtu është e vërtetuar nga Omeri, radijall-llahu anhu, siç qëndron në el-Muvetta’ me sened prej senedeve më të vërteta.

E nëse fal edhe më shumë nuk prishë gjë, ngase kur Resulullahun, alejhi selam e pyetën për namazin e natës, tha: “Nga dy, nga dy”, dhe nuk e ka përkufizuar.

Nga selefi për këtë ka transmetime të ndryshme, si dhe çështja këtu është e gjërë.

Më e mira është që të mjaftohemi me atë që është transmetuar nga Resulullahu, alejhi selam e ajo është njëmbëdhjetë rekate apo trembëdhjetë.

Ndërsa, nuk ka transmetim të vërtetë se Resulull-llahu, alejhi selam apo ndonjëri prej halifëve i ka falur njëzet e tre rekate.

Bile është e vërtetuar nga Omeri, radijallahu anhu, njëmbëdhjetë rekate, si dhe i ka urdhëruar Ubej ibën Ka’bin dhe Temim ed-Darijun, radijallahu anhuma, që t’ua falin njerëzve nga njëmbëdhjetë rekate.

Kështu dhe i ka hije Omerit, radijallahu anhu, që të shkon udhës në të cilën ka shkuar Resulullahu, salallahu alejhi ue selem.

E nuk dijmë se sahabët kanë falur më tepër se trembëdhjetë rekate, përkundrazi, ata kanë falur më pak regate.

Parakaloi fjala e Ajshe, radijallahu anha: “As në Ramazan e as jashtë tij nuk shtonte më tepër se njëmbëdhjetë rekate”.

E ixhmai i sahabëve pa dyshim se është argument, ngase aty kanë qenë Halifët e drejtë, për të cilët na ka urdhëruar Resulullahu, alejhi selam që t'i pasojmë dhe ata kanë qenë njerëzit më të mirë të këtij ummeti.

Mirëpo, dije se debati për numrin e rekateve të teravisë është prej gjërave në të cilat lejohet hulumtimi (ixhtihadi), e nuk bën që kjo të jetë shkak për kundërshtime dhe përçarje midis ummetit.

Sidomos duke e ditur se edhe disa nga selefi kanë pasur mendime të ndryshme për këtë, dhe në këtë çështje nuk ka ndonjë argument që e ndalon hulumtimin, studimin në të.

Shih sa mirë i ka thënë njëri prej dijetarëve dikujt që e debatonte në një çështje ku lejohej hulumtimi (ixhtihadi): “Ti, me kundërshtimin që ma bën, je në pajtim me mua, ngase secili prej neve mendon se duhet të pasojë atë për të cilën mendon se është e vërtetë, në gjërat ku lejohet studimi”.

E lusim Allahun të na jep sukses, në atë të cilën Ai e do dhe është i kënaqur.

(marrë nga libri: Kushtet e fesë, NuN 2005)

Muhamed ibën Salih el-Uthejmin

Ndalimi i të menduarit keq për tjerët

39. Ebu Hurejra, radijall-lahu anhu, transmeton se Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sellem, ka thënë: “Ruhuni nga supozimi sepse supozimi është fjala më e rrejshme. Mos hulumtoni as mos përgjoni të metat mes jush, mos keni zili, mos ia ktheni shpinën njëri tjetrit, mos urreni njëri tjetrin por bëhuni robër të Allahut të vëllazëruar.” (Buhariu dhe Muslimi)

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: “O ju që keni besuar, largohuni nga supozimet e shumta sepse disa prej supozimeve janë mëkat” (Huxhurat-12)

Qëllimi i hadithit të lartëpërmendur është ndalimi nga të menduarit keq. Hattabi thotë: Qëllimi është: ndalimi i realizimit dhe besimit të supozimit e jo ajo që shkon ndërmend sepse atë njeriu nuk e zotëron.

Qëllimi i Hattabit është se të menduarit keq është i ndaluar nëse vazhdon dhe zë vend te njeriu e jo ajo që paraqitet kohë pas kohe sepse me këtë njeriu nuk është i ngarkuar. Transmetohet nga Sufjani se ka thënë: Mendimi i keq është mëkat nëse e shpreh atë, e nëse nuk e shpreh nuk bën mëkat.

Sa i takon cilësimit të supozimit si fjalë më e rrejshme, kjo është aludim në supozimet të cilat nuk mbështeten në argumente, për këtë, ai i cili supozon pa argumente dhe e deklaron atë në mënyrë të prerë është rrenacaku më i madh sepse rrena në esencë dihet shëmtimi i saj dhe nuk ka nevoj që të qortohet, përkundër supozimit për të cilin mendohet se ka argument. Për këtë arsye cilësohet si fjalë më e rrejshme duke hiperbolizuar qortimin e kësaj vepre dhe frikësimin nga ajo si dhe duke aluduar se mashtrimi me supozim të paargumentuar është shumë më i madh se rrena e pastër, sepse i pari është i paqartë në të shumtën e rasteve kurse rrena është e qartë.

Ahmed Muadh Hakkij

Përktheu: Agim Bekiri
(libri: Katërdhjet hadithe mbi moralin, NuN, Shkup, 2005)